

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPATAMENTI OBSTETRIKË GJINEKOLOGJISË**

DISERTACION

Roli i Acidit Tranexamik në Hemorragjinë e Paslindjes

Punoi

Dr. Kastriot DALLAKU

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Orion GLIOZHENI

Tiranë, 2021



UNIVERSITETI I MJEKESISE, TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPATAMENTI OBSTETRIKE GJINEKOLOGJISË

DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR I SHKENCAVE MJEKESORE”

TEMA

Roli i acidit tranexamik në hemorragjine e paslindjes.

Mbrohet më datë ____/____/____ para jurisë

1. Prof. Dr. Aferdita Manaj	Kryetar
2. Prof. Dr. Astrit Bimbashi	Anetar (Oponent)
3. Prof. Dr. Ndok Marku	Anetar (Oponent)
4. Prof. Dr. Tatjana Caja	Anetar
5. Prof. Dr. Leonard Deda	Anetar

Mirënjohje

Janë shumë njerëz që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme në këtë disertacion, që unë i detyrohem dhe i falenderoj shumë.

Së pari, falenderoj udhëheqesin shkencor, Prof. Orion Gliozheni, për udhëheqjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm, që në konceptimin e këtij projekti dhe përfundimin me sukses të tij.

Dua të shpreh mirënjohjen time të sinqertë të gjithë atyre kolegeve që dhanë një ndihmë substanciale në këtë projekt, për kolegët nga Universiteti Ludwig Maximilian i Mynihut në Germani: Prof. Ulrich Mansmann, për ndihmën në konceptimin e studimit dhe analizën statistikore; Prof. Wolfgang Schramm, për konsultimet rreth hematologjisë; Dr. Maria Delius, për diskutimet rreth projektit; Dr. Siegmund Braun për kontributin në kryerjen e analizave laboratorike.

Falenderoj kolegët nga LSHTM në Londër, Angli: Dr. Haleema Shakur, për koordinimin me studimin WOMAN trial, dhe Prof. Ian Roberts për shkëmbimin e ideve në lidhje me interpretimin e rezultateve të studimit.

Një falenderim i vecantë për kolegët e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni“, mjekët obstetër gjinekologë, reanimatore si dhe mamitë për pjesëmarrjen e tyre në studim dhe trajtimin me sukses të këtij komplikacioni kërcënues për jetën e gruas, hemorragjisë së paslindjes.

Një falenderim i vecantë për sponsorët e studimit ETAPlaT, pa ndihmën e të cilëve ky studim nuk do të ishte realizuar.

Një falenderim për të gjithë gratë që morën pjesë në këtë studim, dhe për interesin që treguan për këtë punë kërkimore.

Gjithashtu, falenderimi i fundit por jo më i vogli është për familjen time, për durimin dhe për mbështetjen e tyre të vazhdueshme e të pafund, për babain Bajam dhe bashkeshorten Irma e kontributin e tyre edhe si kolegë, si dhe për vajzat e mia Antea dhe Elia.

Abstrakt

Hyrje.

Hemorragjia postpartum (HPP) është shkaku kryesor i mortalitetit dhe morbiditetit matern. Studimi WOMAN trial tregoi që acidi traneksamik (TXA) redukton vdekjet materne për shkak të hemorragjise në pacientet e diagnostikuara me HPP. Për të përcaktuar nëse acidi traneksamik ka efekte pro-trombotike në pacientet me HPP, në vleresuan gjenerimin e trombinës duke matur potencialin endogjen të trombinës (ETP), faktorët e koagulimit V, VIII, vWF, fibrinogjenin, D-dimerin dhe funksionin trombocitar.

Metoda.

Në realizuam një nën-studim brenda studimit WOMAN trial, që është studim nderkombetar, i randomizuar, me grupe paralele, dyfish i maskuar, placebo i kontrolluar. Grate me hemorragji postpartum primare u ndanë në mënyrë të randomizuar në dy grupe, për të marrë 1 gram TXA ose placebo. U mor një kampion gjaku venoz menjëherë pas randomizimit dhe para aplikimit të trajtimit të studimit, dhe një tjetër kampion gjaku u mor pas 30 ± 15 minuta pas aplikimit të trajtimit të studimit. Në i krahasuam ndryshimet midis grupeve TXA dhe placebo, para dhe pas trajtimit, në parametrat e gjenerimit të trombinës, koagulimit dhe funksionit trombocitar, duke përdorur matjet ANOVA. Ndryshimi në gjenerimin e trombinës ishte rezultati primar. Në kryem një analizë statistikore bazuar në principin “intention-to-treat” duke përdorur ANCOVA, dhe duke përshtatur kohën e marrjes së kampionit të parë dhe intervalin kohor midis dy kampioneve të gjakut.

Rezultatet.

Një total prej 187 pacientesh u randomizuan për të marrë TXA (n=93) ose placebo (n=94). Gjashtë pacientë u përjashtuan nga studimi për shkak të të dhenave jo të plota. Reduktimi i gjenerimit të trombinës nga para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit ishte $43.2 \text{ nM} \cdot \text{min}$ (95%CI, -16.6 to 103.1) në grupin TXA dhe $4.6 \text{ nM} \cdot \text{min}$ (95%CI, -51.4 to 60.6) në grupin placebo. Diferenca nuk ishte statistikisht e rëndësishme (95%CI, -42.9 to 120). Trajtimi me TXA nuk kishte efekte të rëndësishme në parametrat e tjera (ADPtest, TRAPtest, aktivitetin e faktoreve të koagulimit, fibrinogjenit dhe nivelin e D-Dimerit).

Konkluzioni.

Megjithatë inhibimi i fibrinolizës me TXA ka potencialin e rritjes së riskut trombotik, në nuk gjetëm rritje të gjenerimit të trombinës dhe po ashtu nuk kishte rritje të aktivitetit trombocitar. Si konkluzion e evidencës së këtij studimi tregon që trajtimi me acidi traneksamik në grate me hemorragji postpartum, nuk ka efekte substanciale pro-koagulante.

Abstract

Background.

Postpartum haemorrhage (PPH) is a leading cause of maternal mortality and morbidity. The WOMAN trial showed that tranexamic acid (TXA) reduces death due to bleeding in women with PPH. To determine whether TXA has pro-thrombotic effects in women with PPH, we measured endogenous thrombin potential (ETP), coagulation factors V, VIII, von Willebrand, fibrinogen, D-Dimers and platelet function.

Methods.

We conducted a sub-study within the WOMAN trial, an international randomized, parallel-group, double blind, placebo-controlled trial. Women with primary PPH were randomly allocated to receive 1 gram of tranexamic acid or matching placebo. Baseline blood samples were collected just prior to the first dose and a follow up sample was collected 30±15 minutes afterwards. We compared before and after changes in coagulation parameters between treatment groups using repeated measurement ANOVA. Change in ETP was the primary outcome. We did an intention to-treat analysis using ANCOVA with adjustment for baseline and the time interval between the blood samples.

Results.

A total of 187 patients were randomized to receive TXA (n=93) or matching placebo (n=94). Six patients were excluded due to incomplete data. The reduction in ETP from baseline to follow up was 43.2 nM*min (95%CI, -16.6 to 103.1) in the TXA group and 4.6 nM*min (95%CI, -51.4 to 60.6) in the placebo group. The difference was not statistically significant (95%CI, -42.9 to 120). There were no significant effects of TXA treatment on any other parameters (ADPtest, TRAPtest, coagulation factors activity, fibrinogen levels, D-Dimer level).

Conclusion.

Although the inhibition of fibrinolysis with TXA has the potential to increase thrombotic risk, we found no increase in thrombin generation and no increase in platelet activity with TXA. In conclusion, this study provides evidence that tranexamic acid treatment for PPH has no substantial pro-coagulant effects.

Permbajtja

Abstrakti	4
Lista e shkurtimeve	8
Parathenje	9
1 Hemorragjia e Paslindjes	10
1.1 Shkaqet dhe faktoret e riskut te HPP	12
1.2 Menaxhimi i hemorragjise postpartum.	13
2 Acidi traneksamik	14
2.1 Efektet Anesore te Mundshme te Acidit Tranexamic	16
2.2 Efekti i TXA ne hemorragji	17
2.3 Efekti i TXA ne Hemorragjine Postpartum	17
2.4 Efekti i TXA ne Koagulim	18
3 Objektivi	20
4 Metoda e studimit	20
4.1 Pjesemarreset dhe kriteret e pranimit	20
5 Analiza statistikore e studimit	21
5.1 Percaktimi i numrit te pacienteve ne studim	21
5.2 Analiza e popullatave	22
5.2.1 Analiza e Setit te Plote	22
5.2.2 Analiza Per Protokoll	22
5.2.3 Analiza e nen-grupeve	23
5.2.4 Monitorimi i studimit dhe analiza e te dhenave.	23
6 Procedurat e Miratimit dhe Konsiderata Etike	24
6.1 Aprovimi Etik i Studimit	24
6.2 Informacioni per studimin dhe miratimi	25
7 Randomizimi dhe Maskimi (Blinding)	27
7.1 Randomizimi	27
7.2 Prodhimi i medikamentit, Maskimi e furnizimi me ilacet e studimit.	28
7.3 Administrimi i trajtimit te studimit	28
8 Vendi ku kryhet studimit	29

9	Interventi i studimit ETAPlat	29
10	Rezultatet e Pritshme te Studimit (Outcome)	30
10.1	Rezultati paresor dhe sekondar studimit ETAPLAT	30
10.2	Rezultatet e Pritshme te studimit WOMAN trial	30
11	Procedurat e Operimit Standart.	31
12	Procedurat e kryera per studimin ETAPlaT.	31
12.1	Definicioni HPP dhe matja e sasise se gjakut te humbur	31
12.2	Marrja e mostrave te gjakut dhe procedimi laboratorik	32
12.3	Analiza e Funksionit Trombocitar.	34
12.4	Gjenerimi i Trombines dhe Faktoret e Koagulimit.	35
13	Rezultatet e studimit	36
13.1	Rezultati primar	39
13.2	Rezultatet sekondare	41
14	Diskutimi	44
14.1	Efekti i TXA ne gjenerimin e trombines, ne pacientet me HPP.	44
14.2	Efekti i TXA ne funksionin trombocitar, ne pacientet me HPP.	45
14.3	Efekti i TXA ne fibrinolize dhe koagulim, ne pacientet me HPP.	46
15	Kufizimet e studimit	48
16	Konkluzionet	48
17	Rekomandimet	49
18	Financimet	50
19	Referencat	51
20	Materialet suplementare	56
20.1	Miratimi per Studimin ETAPlaT nga Komiteti Kombetar i Etikes,Tirane. F. 1-2	57
20.2	Miratimi per Studimin ETAPlaT nga Komiteti i Etikes LSHTM, Londer, Angli.F.1	58
20.3	Materiale shtese 1: Flete Informative per Pacienten, Perfaqesuesin e Saj. F. 1-3	60
20.4	Materiale shtese 2: Forma e Miratimit per Pacienten, F. 1	63
20.5	Materiale shtese 3: Forma Miratimit per Perfaqesuesin e Pacientes, F. 1	64
20.6	Materiale shtese 4: Forma Mbledhjes te Dhenave WOMAN-ETAPlaT, F 1-3	65

Lista e shkurtimeve

ETAPlaT:	Effect of T ranexamic Acid on P latelet function and T hrombin generation; (Efekti i acidit traneksamik ne funksionin trombocitar dhe gjenerimin e trombines)
HPP:	Hemorragjia Postpartum;
TXA:	Acidi Traneksamic;
ETP:	Potenciali Endogjen i Trombines;
FVIII:	Faktori Koagulimit VIII;
FV:	Faktori Koagulimit V;
vWF:	Faktori Koagulimit von Willebrand;
MEA:	Multiple Electrode Aggregometry;
ADP test:	Testi i Adenosine Diphosphate;
TRAP test:	Testi i aktivizimit receptorit trombocitar te trombines;
TGA:	Analiza Gjenerimit Trombines;
LSHTM:	London School of Hygiene and Tropical Medicine;
SD:	Deviacioni Standard;
ANCOVA:	Analiza e Kovariances;
DeD:	Diferenca e diferencave;
SUOGJ	Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik
FDA	Food and Drug Administration
APCC	Koncentrati Kompleksit te Protrombines se Aktivizuar

Parathënje

Hemorragjia postpartum është shkaku kryesor i vdekshmërisë dhe morbiditetit amëtar sot në botë. Rreth 140,000 gra vdesin çdo vit nga ky komplikacion, e barabarte me një vdekje amëtare çdo 4 minuta. Shumë nga vdekjet ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta ose të mesme. Por edhe në vendet e zhvilluara, hemorragjia postpartum mbetet shkaku kryesor i vdekshmërisë amëtare (Oyelese et al, 2010).

Hemorragjia obstetrikale shkaktohet më shpesh nga atonia uterine, shkaqet placentare si inserimi defektoz i placentës apo mbetjet placentare, trauma e lindjes (laceracionet uterine, cervikale, vaginale apo perineale), si dhe koagulopatitë. Trajtimi fillestar është të adresojë shkakun shkaku kryesor të hemorragjisë postpartum, si për shembull përdorimi i uterotonikëve për atoninë uterine dhe korrigjimi kirurgjikal për laceracionet.

Prezenca e koagulopatisë apo dhe e shkaqeve të tjera të përmendura më lart, mund ta bëjë hemorragjinë obstetrikale apo postpartum mjaft kërcënuese për jetën, duke rezultuar në transfuzione të shumta të gjakut e nënprodukteve të tij, ndërhyrje kirurgjikale për ndalimin e hemorragjisë dhe histerektomi apo pamundësia e gruas për të patur fëmijë të tjerë, si dhe komplikacioni fatal me vdekje të gruas. Acidi traneksamik, është një inhibitor i fibrinolizës dhe mund të reduktojë hemorragjinë në terrenin e anomalive të koagulimit. Studimet e mëparshme kanë dhënë evidencë, megjithëse të pakta, të benefiteve të përdorimit të acidit traneksamik në hemorragjinë e paslindjes.

Së fundmi studimi WOMAN trial i cili përfshiu 20 060 paciente në vendet me të ardhura të ulëta, të mesme dhe të larta, tregoi një reduktim të rëndësishëm prej 31% të vdekjeve për shkak të hemorragjisë, kur u administrua 1 gram acid traneksamik në rrugë intravenoze brenda tre orëve nga diagnozë e hemorragjisë postpartum (Woman trial collaborators, 2017).

Në këtë studim për të përcaktuar nëse acidi traneksamik ka efekte pro-trombotike në pacientet me hemorragji postpartum, në vleresuar gjenerimin e trombinës, faktorët e koagulimit V, VIII, vWF, fibrinogjenin, D-dimerin dhe funksionin trombocitar.

1 Hemorragjia e Paslindjes

Hemorragjia e cila ndodh në periudhën e paslindjes është përgjegjëse për një të katërten deri një të tretën e vdekjeve amëtare, dhe intervali kohor mesatar nga fillimi i hemorragjisë deri në komplikacionet e rënda kërcënuese për jetën e gruas është 2 deri 4 orë (AbouZahr C, 1998). Hemorragjia e paslindjes gjithashtu shkakton rritje të morbiditetit amtar, duke shtuar incidencën e anemisë paslindjes si dhe mundësinë e hemotransfuzioneve të cilat janë të shoqëruara me risqet e infeksioneve të transmetuara nga gjaku (Ferrer et al 2009). Anemia e rëndë është komplikacion i zakonshëm i hemorragjise postpartum dhe prek rreth 11% të 14 milion grave me HPP në të gjithë botën, çdo vit (AbouZahr C, 2003). Anemia e rëndë mund të shkaktojë dobësi të përgjithshme dhe redukton seriozisht aftësinë e nënës për të kujdesur për fëmijën e saj si dhe redukton kapacitetin e saj për punë (WHO, 1992).

Rreth 1% e lindjeve vaginale mund të kërkojnë hemotransfuzione, por kjo shifra rritet në 5% - 6% për gratë me lindje instrumentale apo me lindje cezariene (Ekeroma et al, 1997). Risku i infeksioneve nga gjaku i transfuzuar është në mënyrë të konsiderueshme më i lartë në vendet që nuk e kontrollojnë gjakun e transfuzuar (OBSH, 2001). Në vendet e zhvilluara, risku i transmetimit të infeksioneve nga gjaku i transfuzuar është i vogël, por reaksionet të lidhura me transfuzionet janë të shpeshta (Taylor et al, 2008). Të tjera komplikacione të HPP se rëndë që e shtojnë morbiditetin matern janë ri-laparatomitë dhe histerektomia obstetrikale e urgjencës.

Analiza e shkaqeve të mortalitetit matern në Shqipëri, rezultoi që 40% të vdekjeve materne ishin shkaktuar nga hemorragjia obstetrikale, ku hemorragjia postpartum kishte vendin kryesor. Shkaqe të tjera ishin preeklampsia në 25%, lindja obstructive në 10%, dhe shkaktare direkte dhe indirekte obstetrikale në 25% të rasteve (OBSH, 2007).

Percaktimi i incidencës së HPP vështirësohet nga dy faktorë si mungesa e një definicioni universal të HPP dhe pasaktësia e vleresimit klinik të sasisë së gjakut në lindje (ACOG, 2006). Për më tepër, incidenca e HPP ndryshon shumë në vartësi të praktikave mjekësore të përdorura dhe të karakteristikave të pacienteve. Për shembull, përqindja e lindjes cezariene, e cila ndryshon shumë sipas vendeve, mund të ketë një impakt në incidencën e HPP.

Gjithashtu, përqindja e pacienteve shtatzëna me anemi është e ndryshme në vende të ndryshme, e cila mund të ndikojë në morbiditetin matern pas HPP. Tradicionalisht, HPP është percaktuar si humbja e gjakut ≥ 500 ml në lindjet vaginale dhe ≥ 1000 ml në lindjet cezariane. Por studime që kanë përdorur markimin me kromatinë të eritrociteve, kanë gjetur që mesatarja e sasisë së gjakut të humbur në lindjet vaginale e kalon sasinë 500 ml (Oyelese et al, 2010).

Kolegji amerikan i obstetër gjinekologëve ka rekomanduar kritere të tjera për diagnozën e HPP (ACOG, 2006). Këto përfshijnë rënjen e hematokritit (diferenca e nivelit para lindjes dhe pas hemorragjisë) me shume se 10%, kërkesën për hemotransfuzion apo instabilitetin hemodinamik të pacientes. Por ndryshe nga vlerësimi vizual që bëhet menjehere në rastet e HPP, vlerësimi objektiv i HPP me ndryshimin e hematokritit bëhet pas stabilizimit të hemodinamikës apo pas rreth 12 orësh.

Hemorragjia postpartum primare është konsideruar nëse ndodh në 24 orët e para pas lindjes. Ndërsa hemorragji postpartum sekondare konsiderohet kur ajo ndodh pas 24 orësh nga lindja deri në ditën e 42 (Cabero Roura et al, 2009). Megjithatë duke u nisur nga këto përkufizime, duhet të merret në konsideratë gjendja pre-egzistuese shëndetësore e gruas, sepse edhe një humbje gjaku në sasinë prej 200 ml, mund të jetë kercënuese për jetën e nje gruaje me anemi të thellë apo me sëmundje kardiake (Lalonde A, et al. 2006).

Incidenca e HPP ndryshon në vartësi të kritereve të përdorura për përcaktimin e saj. Megjithatë, nga vlerësimet vizuale të sasisë së gjakut të humbur është raportuar një incidencë të hemorragjisë së paslindjes rreth 4%, ndërsa kur humbja e gjakut matet në menyrë objektive (ndryshimi i hemoglobines apo hematokritit) kanë raportuar një incidence më të lartë, rreth 10%. Incidenca e hemorragjisë së rëndë (≥ 1000 ml) është raportuar të jetë rreth 1.8%, ndërsa kur humbja e gjakut është matur objektivisht incidenca ka rezultuar më e lartë, 3.1% (Oyelese et al, 2010).

1.1 Shkaqet dhe faktorët e riskut të HPP

Për të kuptuar shkaqet dhe faktorët e riskut të HPP, është e rëndësishme të njohim procesin fiziologjik që parandalon hemorragjinë e madhe të pas lindjes. Shkaku më i zakonshëm i HPP është hemorragjia nga vendi i implantimit të placentës. Metoda kryesore me të cilën hemorragjia ndalon pas lindjes së placentës, është kontraksioni i miometrit i cili bën okluzionin e vazave të mëdha në vendin e inserimit të placentës. Nëse ky mekanizëm dështon, ndodh hemorragjia e paslindjes. Në shtatzani ka një gjendje të rritur të koagulimit krahasuar me grupe jo-shtatzëna, e cila mund të ndikojë në parandalimin e hemorragjise së rëndë të pas lindjes.

Shkaqet e HPP mund të klasifikohen në katër grupe kryesore. Shkaku më i zakonshëm i HPP është atonia uterine, e cila vjen si pasojë e pamjaftueshmërisë të një kontraksioni uterin të përshtatshëm pas shkollitjes së placentës. Atonia uterine mund të parashikohet nëse janë të pranishëm ndonjë nga faktorët e riskut si: mbi-distendim i uterusit nga polihidramnioni, shtatzania multifetale, ose makrosomia fetale. Aktiviteti i zgjatur i lindjes apo lindja precipitoze, mund të çojë në atoni uterine. Aktiviteti precipitoz i lindjes shoqërohet me kontraksione të forta që e lodhin muskulin uterin, gjithashtu kjo ndodh edhe në aktivitetin e zgjatur të lindjes, që rezultojnë në kontraksione uterine jo të përshtatshme dhe atoni uterine. Induksioni apo potencimi i aktivitetit të lindjes mund të rezultojë në atoni uterine.

Trauma e traktit genital është shkaku i dytë më i shpeshtë i HPP, dhe mund të rezultojë nga laceracionet e perineumit, të vaginës, cerviksit uterin apo ruptures uterine. Faktorët predispozues janë spontane apo jatrogjenike si lindja instrumentale me vakum apo forceps dhe po ashtu lindja cezariene.

Shkaku i tretë më i zakonshëm janë mbetjet e fragmenteve placentare, të cilat pengojnë kontraksionet uterine adekuate, dhe si rrjedhim çojnë në atoni uterine dhe HPP. Shkak tjetër placentar është dhe implantimi defektoz i placentës, si implantimi në segmentin e poshtëm uterin, i cili për shkak të kontraksione uterine të dobëta shkakton HPP. Placenta akreta, e cila invadon jo normalisht miometrin mund të jetë shkaku i HPP. Përpyekjet për të ndarë placentën mund të çojnë

në grisjen e placentës dhe si rezultat hemorragji nga sinuset e hapura placentare, ose grisjen e miometrit dhe si rezultat hemorragji.

Shkaqet më të rralla të HPP janë difektet e koagulimit, të fituara apo të trashëguara. Ne rastet e distakos se placentës, hemorragjisë masive apo hemotransfuzionet e shumta, qendrimi i gjate intrauterin i fetusit të vdekur, embolia e likidit amniotik dhe sepsis mund të shkaktojnë difekte të koagulimit. Cregullime të tjera të koagulimit që shkaktojnë hemorragji paslindjes janë: semundja von Willebrandt, trombocitopenia, dhe terapia me antikoagulantë.

Pavarësisht identifikimit të faktorëve të riskut në peridudhën antenatale dhe intrapartum për hemorragjinë e paslindjes, shumica e pacienteve që bëjnë hemorragji postpartum nuk kanë faktorë të tillë, dhe si rezultat cdo shtatzani është në risk për të zhvilluar HPP. Pacientet e identifikuar me risk të lartë për hemorragji obstetrikale, si ato me placenta previa apo akreta, duhet të trajtohen dhe të planifikojnë lindjen në një qendër të kujdesit shëndetësor terciar, me një plan specifik për menaxhim multidisiplinar ku të jenë të përfshirë konsultat me mjekë hematologe, kirurgë vaskular apo urologë (Eller et al, 2011).

1.2 Menaxhimi i hemorragjisë postpartum.

Trajtimi i hemorragjisë postpartum bëhet në varësi të shkakut kryesor të hemorragjisë apo faktorëve kontribues. Terapia mjekesore e linjës së parë për parandalimin e trajtimin e atonisë uterine, është masazhi uterin dhe uterotonikët. Episiotomia dhe laceracionet minore duhet të riparohen në sallën e lindjes. Gratë që kanë hemorragji persistente, pavarësisht këtyre manovrave, mund të transferohen në sallën operatore për të lejuar një egzaminim nën anestezinë e përshtatshme, dhe për të lejuar një ndërhyrje kirurgjikale të shpejtë, përfshirë ketu dhe laparotomine nëse është e nevojshme. Interventi tjetër mund të jetë tamponada me ballonin intrauterin, dhe gjatë laparotomisë suturat kompresive të uterusit. Një studim (Doumouchsis et al, 2007) raporton se tamponada me ballonin intrauterin ka rezultuar e sukseshme për të parandaluar një hysterektomi në 85 – 90 % të rasteve.

Histerektomia e kryer në gratë me hemorragji postpartum të rëndë apo hemorragji rezistente ndaj mjekimit, është procedurë që shpëton jetën. Problemi është se pacientet që kanë hemorragji dhe kanë humbur shumë gjak, i nënshtrohen kësaj procedure kirurgjikale dhe humbasin edhe me shumë gjak. Menaxhimi optimal i hemorragjisë paslindjes, duhet të marrë në konsideratë etiologjinë kryesore të hemorragjisë, stadin e hemorragjisë si dhe kërkesat hematologjike të rastit (Rossi et al, 2010).

Koagulopatia që shoqëron HPP, mund të jetë për shkak të hemodiluimit nga perfuzionet endovenoze të marra gjatë reanimimit agresiv apo nga zëvendësimi jo i mjaftueshem me nenproduktet e gjakut. Një shkak tjetër i koagulopatisë është pamjaftueshmëria e funksionit hepatic që ndodh në insuficiencën hepaticë akute të shtatzanise ose në koagulimin intravascular të diseminuar, e cila mund të ndodhë në distakon e placëntës, qëndrimi i gjatë intrauterin i fetusit të vdekur si dhe embolia e likidit amniotik (Cotton et al, 2006).

Ka një hipotezë që në disa kushte të caktuara, faktorët indorë placentar, produktet e konceptimit dhe likidi amniotic hyjnë në qarkullimin e gjakut amëtar dhe veprojnë si një aktivizues potencial i kaskadës ekstrinsike të koagulimit. Fibrinoliza që e pason, con në prodhimin e d-dimerëve dhe mund të përkeqësojë hemorragjinë postpartum duke ndikuar në kontraktilitetin uterin dhe funksionin trombocitar (James et al, 2012). Terapia me anti-fibrinolitike është përdorur në disa studime për trajtimin e HPP. Studimi WOMAN trial ka analizuar përdorimin e TXA në 20060 paciente, ku nga rezultatet e këtij studimi raportohet që TXA redukton rrezikun e vdekjes amëtare për shkak të hemorragjisë paslindjes (Woman trial collaborators, 2017).

2 Acidi Traneksamik

Në shtator 1957 mjeku japonez Okamoto, raportoi zbulimin e një entiteti kimik që frenonte shkatërrimin enzimatik të fibrinës nga plasmina, dhe që u quajt acidi traneksamik (Ortmann et al, 2013). Acidi traneksamik [*trans-4-(aminomethyl) cyclohexane-1-carboxylic acid*] është një derivat sintetik i aminoacidit lizinë, që frenon aktivizimin e plasminogenit në plasminë. Acidi traneksamik është gjithashtu një inhibitor i aktivizuesit indor të plasminogenit.

Ai bllokoi vendet lidhëse të lizines të plasminogenit, duke rezultuar në frenimin e aktivizimit të plasminogenit dhe lidhjes së fibrinës me plasminogenin, dhe kështu frenimin e fibrinolizës (Figura 1). Gjithashtu TXA mund të frenojë direkt aktivitetin e plasminës, por vetëm në doza të mëdha TXA mund të reduktojë formimin e plasminës (Hunt B, 2015).




Figura 1. Mekanizmi i veprimit të acidit traneksamik. Vendi i lidhjes së plasminogenit me fibrinen i okupuar nga TXA, duke parandaluar fibrinolizen. t-PA – aktivizuesi plasminogenit indor. PDF – produktet e degradimit të fibrinës.

Ky medikament administrohet në rrugë orale ose me rrugë venoze, pas të cilit piku i përqendrimit plasmatik arrihet shpejt. TXA ekskretohet si një medikament i pandryshuar në urine, me një gjysmë-jete eliminimi rreth 3 ore (Roberts et al, 2014).

Hemorragjia obsterikale karakterizohet nga aktivizimi i sistemit fibrinolitik. Acidi traneksamik është një agjent potent farmaceutikal që frenon fibrinolizën dhe mund të përdoret për të menaxhuar hemorragjinë në shtatzani (Peitsidis et al, 2011).

Acidi traneksamik është një agjent antifibrinolitik kompetitiv, i përdorur në të gjithë botën për më shumë se 30 vjet për të trajtuar menorrhaginë, dhe për të minizuar humbjen e gjakut në ndërhyrje të ndryshme kirurgjikale. Acidi traneksamik në studimet *in-vitro* ka rezultuar se është 6 deri 10 herë më i fuqishëm se antifibrinolitiket e tjerë, si acidi ϵ -aminokaproik (Dunn et al. 1999). Duke

zotëruar këtë efekt antifibrinolitik, klinikistët hezitojnë të përdorin TXA gjatë shtatzanisë për shkak të riskut potencial të trombombolisë tek gruaja.

Klasifikimi sipas FDA (Administrata Amerikane e Medikamenteve dhe Ushqimit) për përdorimin e TXA në shtatzani, e klasifikojnë atë në kategorinë B, ku studimet në riprodhimin e kafshëve nuk kanë demonstruar ndonjë risk fetal, por nuk ka studime të standartizuara në gratë shtatzëna. Acidi traneksamik e kalon shtratin placentar. Ekskretimi i TXA është i ulët në qumështin e gjirit në gratë në laktacion, dhe është rreth 1% e pikut të koncentrimin plasmatik amëtar (Peitsidis et al, 2011).

2.1 Efektet Anësore të Mundshme të Acidit Traneksamik.

Meqenëse TXA inhibon shkatërrimin e depozitave të fibrinës, tashmë të formuar, teorikisht mund të rrisë riskun e trombombolisë. Megjithatë, rishikimet sistematike të studimeve të TXA në kirurgji nuk treguan rritje statistikisht signifikante të riskut të ngjarjeve trombombolike (Henry DA, et al.2007).

Gjatë shtatzanisë, gratë kanë një risk të rritur të ngjarjeve trombombolike, krahasuar me grate joshatzëna. Risku absolut i trombombolisë venoze simptomatike gjatë shtatzanisë është vlerësuar të jetë midis 0.5 dhe 3 për 1000 gra, bazuar në studimet radiografike (Gherman RB, et al.1999; Lindqvist P et al, 1999; Toglia et al, 1996). Studimet raportuan që trombozat venoze të thella antepartum janë po aq të shpeshta sa trombozat postpartum, dhe ndodhin me një shpeshësi të njëjtë në të gjithë tremestrat (Lindqvist P et al, 1999).

Një studim kohort vlerësoi incidencën e ngjarjeve trombombolike të jetë rreth 200 për 100.000 gra në vit (Heit JA, et al.2005). Trombozat venoze të thella ishin tre herë më të shpeshta se trombembolia pulmonare dhe ngjarjet trombombolike ishin pesë here më të shpeshta në periudhën postpartum se gjatë shtatzanisë. Kjo ishte vecanërisht e evidente me emboline pulmonare, e cila ishte 15 herë më e mundur të ndodhte në periudhën postpartum se gjatë shtatzanisë.

TXA kalon në qumështin e gjirit në përqendrime shumë të vogla, afërsisht një të njëqindën e përqendrimit në gjakun matern. Efekti antifibrinolitik në të porsalindurit është shumë pak i mundur të ndodhë në këtë përqendrim kaq të ulët (Emc, 2009). Në studimin WOMAN trial nuk u raportuan ngjarje trombembolike në fëmijët që ushqehen me gjë, në grupet TXA apo placebo. TXA nuk është një medikament i ri dhe në përgjithësi është i toleruar mire. Efekte anesore janë të pazakonta dhe zakonisht manifestohen si nausea, diarreja ose ndonjëherë reaksionet ortostatike (Dunn et al, 1999).

2.2 Efekti i TXA në Hemorragji.

Antifibrinolitikët sistematikë janë përdorur gjerësisht në kirurgji me qëllim që të reduktohen humbjet kirurgjikale të gjakut. Një rishikim sistematik i studimeve klinike të randomizuara me agjentët antifibrinolitikë në pacientët kirurgjikal, identifikoi 211 studime që përfshinin 20781 paciente.

Rezultatet treguan që TXA redukton kërkesat për marrjen e hemotransfuzionit me 39% (RR = 0.61, 95% CI 0.54 to 0.69). Në të gjithë pacientet, TXA reduktoi volumin e gjakut të transfuzuar me 1.1 njësi (95% CI 0.64 to 1.59). TXA mund të reduktojë kërkesat për ri-laparotomi për shkak të hemorragjisë (RR = 0.67, 95% CI 0.41 to 1.09). Gjithashtu nuk pati evidencë për një rritje të riskut të ngjarjeve trombotike (Dun et al, 1999).

Studimi CRASH 2 i kryer në pacientet që kanë pësuar trauma, tregoi që TXA nëse është administruar brenda tre orëve nga dëmtimi, redukton në mënyrë të rëndësishme vdekjen për shkak të hemorragjisë, dhe pa ndonjë rritje të eventeve trombembolike (Shakur et al, 2010).

2.3 Efekti i TXA në Hemorragjinë Postpartum.

TXA redukton në mënyrë të rëndësishme hemorragjinë uterine në gratë me metrorragji dhe është rekomanduar në Angli si trajtim në rastet e hemorragjisë postpartum rezistente ndaj trajtimit (RCOG, 2007). Një rishikim sistematik i studimeve të randomizuara të TXA në PPH, identifikoi tre studime me përdorimin profilaktik të TXA që përfshinin 460 paciente (Ferrer et al, 2009).

Megjithëse ishte një reduktim statistiki i sasisë së gjakut të humbur postpartum (mesatarisht 100 ml reduktim), metodologjia e studimeve të analizuara, ishte e varfer. Asnjë nga studimet nuk kishte maskim të shpërndarjes së trajtimit TXA/placebo, dhe studimet ishin të vogla për sa i përket numrit të pjesëmarrësve në studim, për të vlerësuar efektin e TXA ndaj mortalitetit amëtar, hysterektomisë dhe ndaj efekteve anësore trombotike.

Udhëzuesi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë rekomandon që TXA të përdoret nëse trajtimet e tjera deshtojnë të ndalojnë hemorragjinë e paslindjes, por cilëson se cilësia e evidencës ku bazohet ky rekomandim është e ulët, dhe rekomandon studime të mëtejshme të TXA në PPH. Gjithashtu së fundmi, edhe rezultatet e studimit WOMAN trial e konfirmuan që TXA ka potencialin të reduktojë vdekjen amëtare për shkak të hemorragjisë postpartum (Woman trial collaborators, 2017).

Gjatë lindjes, kur placenta shkëputet nga muri uterin, ndodhin një rradhë ndryshimesh fiziologjike dhe hemostatike që reduktojnë hemorragjinë: kontraksione të forta miometriale, rritje e aktivitetit trombocitar, çlirim masiv i faktorëve të koagulimit dhe rritje paralele e aktivitetit fibrinolitik (Hellgren M, 2003). Si rrjedhim, ka një arsye teorike për të përdorur agjentët antifibrinolitik për trajtimin e hemorragjisë postpartum. (Dunn et al, 1999; Bonnar J et al, 1980; Bolte et al, 2005)

2.4 Efekti i TXA në Koagulim.

Në procesin hemostatic, koagulimi ndodh shpejt në vendin e vazes së dëmtuar, duke ndërtuar një rrjetë të hollë fibrine, ndërsa në të njetën kohe, sistemi fibrinolitik heq depozitat e fibrines që mund të shkaktojnë okluzion menjëherë pasi ka ndodhur riparimi vaskular (Prentice CR, 1980). Sistemi i koagulimit dhe fibrinolizës besohet që janë në një gjendje të balancës dinamike, e cila ruan hemostazën dhe mban intakt sistemin vaskular. Acidi traneksamik redukton hemorragjinë duke frenuar degradimin enzimatik të fibrinës nga plasmina (Pacheco et al, 2017).

Përveç rolit në fibrinolizë, plasmina ka efekte të ndryshme në faktorët e koagulimit. Faktorët e koagulimit V (FV) dhe VIII (FVIII) fillimisht aktivizohen dhe pastaj inaktivizohen nga plasmina.

Ativizimi fillestar i këtyre faktoreve të koagulimit mund të gjenerojë mjaftueshem trombine për të krijuar një efekt prokoagulant. Gjithashtu plazmina mund të nxisë gjenerimin e trombinës duke inaktivizuar inhibitorin e faktorit indor (TFPI) që është një inhibitor madhor i nxitjes së gjenerimit të trombinës nga faktori indor (Godier et al., 2012). Ogiwara et al. (2010) thekson që gjenerimi i trombinës rritet në prezencë të plazminës. Nëse plazmina rrit prodhimin e trombinës, TXA duke inhibuar plasminën, duhet të reduktojë gjenerimin e trombinës.

Megjithëse TXA redukton hemorragjinë nga inhibimi i fibrinolizes, ai mund të reduktojë hemorragjinë edhe nepermjet mekanizmave të tjerë. Për shembull, TXA mund të përmirësojë funksionin trombocitar (Boylan et al., 1996). Ekspozimi i trombociteve me plazminën indukon aktivizimin trombocitar (Ervin & Peerschke, 2001). Plazmina aktivizon trombocitet nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, sic janë stimulimi i kaskadës së acidit arakidonik, induktimi i degranulimit trombocitar dhe aktivizimi i komplementit (Godier et al., 2012). Efekti kryesor i TXA në funksionin trombocitar mund të jetë për shkak të inhibimit të plazminës, dhe rrjedhimisht pakësimi i induktimit multifaktorial të plazminës në trombocite.

TXA përmirësoi funksionin trombocitar në pacientet që iu nënshtruan kirurgjise kardiake, të cilët kishin dëmtim të funksionit trombocitar nga ekspozimi me terapine antitrombocitare, sic është Clopidogrel (Shi et al., 2013). Një tjetër studim në pacientet e kirurgjisë kardiake (Weber et al., 2011), tregon se administrimi i TXA përmirësoi në mënyrë signifikante funksionin trombocitar duke dobësuar defektet e agregimit trombocitar të krijuara nga trajtimi antitrombocitar.

Në pacientët me insuficiencë kronike renale, administrimi i TXA korrigjoi defektet e agregimit trombocitar (Mezzano et al., 1999), dhe si rezultat përmirësoi funksionin trombocitar. Gjithashtu Sabovic et al. (2005) raportoi që disfunksioni trombocitar në pacientet e hemodializës u korrigjua në mënyrë efektive nga administrimi për një kohë të gjatë me një dozë të vogël të TXA.

3 Objektivi i Studimit

Ky studim do të vleresojë efektin e TXA në gjenerimin e trombinës dhe funksionin trombocitar në pacientët me hemorragji postpartum. Nëse aktivizimi i plazmines rrit gjenerimin e trombinës dhe stimulon aktivizimin e trombociteve, në hipotezohet që duke inhibuar plazminën, TXA do të reduktojë gjenerimin e trombinës dhe do të inhibojë aktivitetin trombocitar në pacientet me hemorragji postpartum.

4 Metoda e Studimit

ETAPlaT (Effect of Traneksamic Acid on Platelet Function and thrombin Generation) është një nën-studim i **World Maternal Antifibrinolytic trial (WOMAN)**, metoda e të cilit është: studim ndërkombëtar, i randomizuar, dyfish i maskuar (double blind), dhe placebo e i kontrolluar. Si një nën-studim, ETAPlaT nuk ka ndryshim të metodës së studimit WOMAN trial, por për specifikën e nën-studimit janë shtuar disa teste laboratorike dhe egzaminime.

Studimi WOMAN trial është zhvilluar në periudhën kohore midis Marsit 2010 dhe Prill 2016, në 195 spitale dhe në 21 shtete në të gjithë botën duke përfshirë 20060 paciente (Shakur et al, 2017). Studimi WOMAN trial në SUOGJ “Koço Gliozheni” në Tiranë ka filluar me datë 28.05.2010, dhe me vone në disa spitale tjera si Spitali Elbasan, Spitali Lezhe, Spitali Vlorë.

Ndërsa nën-studimi ETAPlaT ka filluar në Nentor 2013 në një spital të vetëm, SUOGJ Koço Gliozheni në Tiranë. Studimi është kryer në përputhje udhëzimet praktikës së mirë klinike (ICH-GCP, 2018). Protokollin e detajuar të studimit WOMAN ETAPlaT është publikuar (Dallaku et al, 2016a).

4.1 Pjesëmarrësit dhe kriteret e pranimit

Menjëherë pas lindjes, i gjithë kujdesi shëndetësor i jepet gruas për parandalimin e trajtimit të HPP. Një sasi e vogël hemorragjie pritet të ndodhë pas lindjes. Kur hemorragjia vazhdon dhe është vendosur diagnoza e HPP, i gjithë trajtimi i disponueshëm është dhënë për trajtimin e HPP, në të njëjtën kohë që është bërë vlerësimi i pacientes dhe përfshirja e saj në studim, sa më shpejt është e mundur.

Kriteret e pranimit: Pjesëmarrëset në studim janë gra me moshën ≥ 16 vjece, me diagnozë klinike të hemorragjisë postpartum primare pas lindjes vaginale apo cezariane (brenda 24 orëve të para të lindjes). Meqenese diagnoza është klinike, ne specifikuam që diagnoza HPP është bazuar në vlerësimin klinik të sasisë së gjakut të humbur, në një nga kriteret e mëposhtme: Sasia e gjakut të humbur pas lindjes vaginale $\geq 500\text{mL}$, ose pas lindjes cezariane $\geq 1000\text{mL}$, ose sasia e gjakut të humbur pas lindjes e mjaftueshme për të kompromentuar gjendjen hemodinamike të pacientes. Kriteret e pranimit janë bazuar në principin e pasigurisë (Peto et al, 1998). Gjithashtu miratimi i informuar i pacientes është marrë sipas procedurave të miratuara të studimit.

Kriteret e përjashtimit: pacientet e diagnostikuara me HPP për të cilat mjeku kurues beson se ka një indikacion të sigurtë apo kundëriindikacion për përdorimin e TXA, nuk janë randomizuar në studim.

5 Analiza statistikore e studimit

5.1 Përcaktimi i numrit të pacientëve në studim

Studimi vlerëson efektin e TXA krahasuar me placebo duke përcaktuar ndryshimin në kohe (para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit) të rezultatit primar ETP (potenciali endogjen i trombinës) dhe një serie rezultatesh dytësore. Studimi krahason ndryshimet para dhe pas aplikimit (trajtimit të studimit) në të dy grupet TXA dhe placebo (diferenca e diferencave).

Llogaritja e numrit të pacientëve që duhet të përfshihen në studim (sample size) është bazuar në supozimin: ETP në gratë shatatëzëna është mesatarisht $2410 \text{ nM} \cdot \text{min}$ dhe deviacioni standart (SD) $543 \text{ nM} \cdot \text{min}$ (McLean et al, 2012). Në supozojmë një ulje të ETP në masën 10% ($241 \text{ nM} \cdot \text{min}$) në grupin e pacientëve që marrin TXA, dhe pa ndryshim në grupin e pacientëve që marrin placebo. Për llogaritja e diferencës së gabimit standart është bazuar në korrelacionin 0.6 midis dy momenteve kohore (para e pas trajtimit të studimit) dhe përdor deviacionin standart të raportuar më parë $485 \text{ nM} \cdot \text{min}$ (McLean et al, 2012). Për të zbuluar një diferencë të diferencave të ETP =

241 nM*min midis dy grupeve të studimit, me një nivel signifikance 5% dhe fuqi alfa (power) 90%, $\{\sqrt{2 \times 543^2 \times (1-0.6)}\}$ kërkohen dy grupe (TXA dhe placebo) me secili 88 paciente.

5.2 Analiza e popullatave

5.2.1 Analiza e Setit të Plotë.

Analiza e efektshmërisë parësore bazohet në principin “intention-to-treat“, e cila le të kuptohet që të dhënat e studimit janë analizuar bazuar në shpërndarjen origjinale të pacienteve, pavarësisht trajtimit të marrë. Pacientet që janë terhequr nga studimi, ata që kanë humbur ndjekjen e mëtejshme dhe ata që nuk kanë aderuar plotësisht protokollin e studimit ETAPlaT, nuk janë përjashtuar nga analiza e efektshmërisë parësore, duke siguruar që i kanë plotësuar kriteret madhore të pranimit. Pacientet që kanë terhequr konsensusin për të përdorur të dhënat e tyre, janë përjashtuar nga analiza e setit të plotë (Figura 3).

5.2.2 Analiza Per Protokoll.

Ky grup konsiston në të gjithë pacientet që nuk devijojnë substancialisht nga protokollin e studimit dhe përcaktohen në bazë të subjektit. Grupi analizes për protokollin e subjekteve përbën një pjesë të setit të plotë dhe karakterizohet si me poshte: (1) të gjitha matjet të disponueshme, (2) pa shkelje madhore të protokollit, (a) pamundësi për të administruar dozën e parë të studimit, (b) pamundësi për të marrë mostrat e gjakut (para ose pas trajtimit), (c) kapërcimi i kohës 30 min ± 15 minuta midis aplikimit të trajtimit të studimit dhe marrjes së mostrës gjakut pas trajtimit.

5.2.3 Analiza e nen-grupeve

Meqenëse numri total i pacienteve të studimit ETAPlaT është relativisht i vogël, nuk u planifikua të kryhet analizë të nën-grupeve për efektin e trajtimit TXA/placebo, për të përjashtuar riskun e fals pozitivitetit.

5.2.4 Monitorimi i studimit dhe analiza e të dhënave.

Monitorimi i studimit në SOUGJ “Koço Gliozheni“, verifikimi i të dhënave në burim dhe rishikimi i dosjes kryesore të studimit, është kryer nga Sponsor (LSHTM) dhe menaxhimi i të dhënave klinike dhe laboratorike është kryer nga Komiteti Monitorimit të Dhënave i LSHTM, në Angli, duke përdorur një sistem elektronik të krijuar enkas. Plani i analizës statistikore të studimit ETAPlaT është publikuar para hapjes së të dhënave për analizë të database-it në LSHTM, Angli (Dallaku et al, 2016b).

E gjithë analiza statistikore finale është kryer në LSHTM, Angli bazuar në database-n e të dhënave atje, bazuar në dokumentimin e formave të mbledhjes së të dhënave (dokumenti suplementar 4), pastrimi i të dhënave, sqarimi i pyetjeve në lidhje me të dhënat, rezultatet laboratorike, publikimi i analizës statistikore i cili është miratuar nga Komiteti Drejtues i Studimit në LSHTM, Angli dhe plotësimi i të gjithë kushteve për hapjen (unblinding) e të dhënave.

Ne krahasuam ndryshimet para dhe pas marrjes së trajtimit të studimit në parametrat e koagulimit, midis grupeve duke përdorur matjet e përsëritura ANOVA. Analiza “intention-to-treat“ e pacienteve të randomizuar në grupet e trajtimit me TXA dhe placebo, është kryer duke përdorur analizën kovariance (ANCOVA) me përshtatjen e matjeve para trajtimit të studimit dhe gjithashtu përshtatjen e gjatësisë së intervalit kohor midis dy marrjeve të gjakut (30±15 minuta). E njëjta analizë është kryer për rezultatet sekondare.

6 Procedurat e Miratimit dhe Konsiderata Etike

6.1 Aprovimi Etik i Studimit

Aprovimi etik i protokollit të WOMAN ETAPlaT është marrë nga Komiteti Kombëtar i Etikes në Tiranë me datë 11. 07. 2013 me numer reference 62 dhe një amendament datë 01. 12. 2014 me numër reference 81. Komiteti Etikes së London School of Hygiene and Tropical Medicine (LSHTM) në Londer, Angli e ka aprovuar protokollin e studimit WOMAN ETAPlaT në datë 28. 10. 2013 me numër reference 6518. Të dy dokumentet gjenden në materialet suplementare (1, 2).

Ky është një studim që do të përfshijë gratë menjëherë pas lindjes së bebit. PPH është një urgjencë obstetrikale dhe pavarësisht njohjes së faktoreve të riskut, nuk është e mundur të parashikohet se cila grua do të ketë një komplikacion të tillë. Në këtë situatë emergjence aktivitetet klinike do të drejtohen në dhënjen e shërbimit shëndetësor të urgjencës të trajtimit të HPP. Pacientet e përshtatshme për këtë studim kanë një komplikacion kërcënues për jetën sic është HPP.

Për më tepër gjendja e tyre emocionale, mendore dhe fizike mund të jetë e alteruar si pasojë e humbjes së gjakut, dhimbjeve të lindjes apo medikamenteve të administruara gjatë lindjes. Në këtë situatë është e rëndësishme që para se të randomizohet në studim një paciente me HPP, të jetë kryer procesi i marrjes së miratimit të informuar të pacientes. Kjo procedure e marrjes së miratimit është kryer sipas parimeve të “Konferencës Ndërkombëtare të Harmonizimit dhe Praktikës së Mirë Klinike” dhe Deklaratës së Helsinkit (ICH-GCP, 2018).

6.2 Informacioni për studimin

Pjesa më e madhe e grave lindin pa komplikacionin e hemorragjisë së paslindjes. Gjithashtu, nuk është e mundur të identifikohet më përpara se cila grua do të ketë HPP. Kur është e mundur, një përmbledhje e informacionit të studimit (dokumenti suplementar 1, fleta informative) i jepet grave shtatzëna në periudhën antenatale, si dhe në momentin e shtrimit në spital.

Refuzimi i pacienteve për të konsideruar pjesëmarrjen në studim, është dokumentuar dhe vendimi i tyre është respektuar. Në rastet kur pacientja është diagnostikuar me HPP, egziston një situatë emergjence klinike dhe shpesh here kritike. Procesin për dhënjen e informacionit dhe marrjen e miratimit, varet nga kërkesa për ndërhyrje urgjente, gjendja fizike e pacientes si edhe gjendja

mendore e emocionale e saj. Gjithashtu, gatishmëria e të afërmeve të pacientes për të marrë një vendim për pacienten, është marrë në konsideratë.

Ne momentin e diagnozës së HPP, gruas i është dhënë informacion për studimin nëse nuk ka patur informacion më parë, nga mjeku apo mamia. Faktoret të cilët mund të dëmtojnë nivelin e koshiençës për shkak të medikamenteve të marra dhe sasisë së gjakut të humbur, janë marrë në konsideratë. Fleta informative (dokumenti suplementar 1 – fleta informative) i është dhënë dhe diskutuar me gruan, si dhe është marrë miratimi (konsensusi) me shkrim (dokumenti suplementar 3, forma e miratimit e pacientes). Kur gruaja është e paaftë të lexojë, fleta informative i lexohet asaj dhe ajo firmos fletën e miratimit ose vendos gjurmën e gishtit.

Kur kapaciteti mendor i pacientes është i dëmtuar, informacioni i jepet pacientes duke marrë në konsideratë nivelin e dëmtimit të kapacitetit të saj mendor. Refuzimi verbal i gruas është respektuar, dhe nuk është përfshirë në studim. Kur i afermi i pacientes është i pranishëm, i jepet informacioni për studimin (dokumenti suplementar 1, fleta informative), dhe i merret miratimi me shkrim (dokumenti suplementar 2, forma e miratimit e përfaqësuesit pacientes). Kur përfaqësuesi i pacientes nuk ishte i pranishëm, dhe gruaja ishte e paaftë të japë miratim të vlefshëm me shkrim, një mjeku ose mamie i është kërkuar të japë miratimin me shkrim si përfaqësues profesional i pacientes.

Gratë e përfshira në studim në emergjenca të tilla, janë informuar sa më shpejt ishte e mundur për të dhënë miratimin e tyre me shkrim, për vazhdimin e procedurave të studimit. Kërkesat që lidhen me aprovimin e Komitetit të Etikës, janë zbatuar gjatë gjithë kohës së studimit.

7 Randomizimi dhe Maskimi (Blinding)

Pacientet me diagnozë klinike të hemorragjisë postpartum dhe që përmbushin kriteret e pranimit dhe që kanë plotësuar procedurën e miratimit, randomizohen në studim dhe alokohen për të marrë trajtimin aktiv (acid traneksamik) ose placebo (Natrium Clorate 0.9%). ETAPlaT është një nën-

studim i WOMAN trial, dhe ka përdorur të njejtin procedurë të randomizimit dhe maskimit (blinding).

7.1 Randomizimi

Kodet e randomizimit janë gjeneruar dhe siguruar nga një konsultant statistikor i pavarur nga “Sealed Envelope Ltd” në Angli. Kodet i janë dhënë “Brecon Pharmaceuticals Limited” në Angli për krijimin e pakove të trajtimit në përputhje me listen e randomizimit. Gjithashtu kutitë dhe pakot e ilaceve të studimit janë identike, kështu që si pacientet ashtu dhe personeli mjekësor janë të maskuar “blinded” ndaj shpërndarjes së trajtimit të studimit.

Secila kuti përmban tetë pako trajtimi individual, secila pako trajtimi përmban dy doza të ilaceve të studimit (një dozë përmban: 2 ampula secila nga 500 mg – 5 ml TXA, ose 2 ampula secila me 5ml Natrium Klorat 0.9%), dy shiringa sterile 10 ml, me age 21FG, dhe stikers për ngjitjen në kartelën mjekësore dhe format e mbledhjes së të dhënave. Pakot janë përdorur nga numri më i vogël dhe me rradhë, nga personeli mjekësor.

Informacioni bazë është mbledhur në fletën e mbledhjes së të dhënave hyrëse (dokumenti suplementar 4, forma mbledhjes të dhënave), dhe është përdorur pako me numrin më të vogël nga kutia me tetë pako. Kur ampula e trajtimit është konfirmuar intakte, në këtë moment pacientja konsiderohet e randomizuar në studim. Forma e plotësuar me të dhënat e hyrjes, është dërguar në qendrën kryesore të studimit LSHTM, në Angli sa më shpejt ishte e mundur.

7.2 Prodhimi, Maskimi dhe Furnizimi me Medikamentin e Studimit.

Procesi i prodhimit të medikamentit dhe furnizimi i qendrës ku u realizua nën-studimi ETAPlaT, u krye nga sponsori kryesor i studimit WOMAN trial, LSHTM në Angli. Medikamenti aktiv i studimit acidi tranexamic (Cyclokapron), është prodhuar nga “Pfizer Ltd” dhe solucioni i Placebo

(Natrium Clorate 0.9%) nga “South Devon Healthcare NHS Trust” sipas rregullave të prodhimit të medikamenteve mjekësore, në Angli.

Ampulat dhe paketimi janë identike në dukje. Procesi i maskimit (blinding) është bërë nga “Brecon Pharmaceuticals Limited”, në Angli. Procesi i maskimit ka përfshirë heqjen e etiketave origjinale të prodhimit dhe zëvendësimin me etiketën e studimit klinik, dhe një numër randomizimi i cili është përdorur si identifikues i pakos.

Të gjitha shkrimet e tjera të pakos janë identike si për pakot e TXA ashtu edhe për placebo, dhe janë në përputhje me kërkesat për investigimin e produkteve mjekësore. Pakot e trajtimit që përmbajnë TXA dhe placebo janë paketuar në blloqe nga 8 (4 TXA : 4 placebo) në një kuti në rradhitje rastësore.

“Brecon Pharmaceuticals Limited“ është përgjegjës për mbajtjen e dosjes specifike të produktit, deri në mbylljen finale të database-it dhe hapjen (un-blinding) e të dhënave të studimit. Kontrollat e cilësisë për të siguruar procesin e maskimit (blinding) janë kryer në kutitë e përgatitura, të përzgjedhura në mënyrë rastësore.

Qendra kryesore e studimit në Angli është përgjegjëse për sigurimin e të gjitha aprovimeve, para se preparatet e studimit të shkojnë në qendrat e studimit.

7.3 Administrimi i trajtimit të studimit

Trajtimi i studimit konsiston në dy doza. Doza e parë ka 2 ampula të cilat mund të jenë placebo ose acid tranexamik 1 gram - janë administruar me injeksion intravenoz me shpejtesi 1 ml në minutë, tek të gjitha gratë e randomizuara, sa me shpejt ishte e mundur pas randomizimit.

Doza e dytë ka 2 ampula të cilat mund të jenë placebo ose acid tranexamik 1 gram, e cila administrohet me injeksion intravenoz me shpejtesi 1 ml në minutë, nëse pas 30 minutash pas aplikimit të dozës së parë hemorragjia vazhdon, ose nëse ndalon dhe rifillon brenda 24 orësh së

dhënjes së dozës parë. Preparatet e studimit nuk janë përzier në sistemin e perfuzionit endovenoz me gjakun e transfuzionit, ose solucionet që përmbajnë penicilinë ose manitol.

Ka një spekter të gjerë të medikamenteve të linjës së parë dhe të dytë për trajtimin e HPP, sic janë oksitocina, metergina etj. Këto trajtime janë përdorur sipas udhëzuesve klinike që ka cdo qendër për trajtimin e HPP, dhe këto informacione janë hedhur në formën e mbledhjes së të dhënave të rezultateve (dokumenti suplementar 4, forma mbledhjes të dhënave). Trajtimi i studimit TXA ose placebo është një trajtim shtesë për menaxhimin e HPP.

8 Vendi ku kryhet studimit

Për zhvillimin e nën-studimit WOMAN ETAPLaT është zgjedhur një qendër e vetme, në Shqipëri. Kjo është justifikuar me faktin që HPP është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve amëtare në Shqipëri (OBSH, 2007). Vendi i përzgjedhur për studimin është Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik (SUOGJ) “Koço Gliozheni“ në Tiranë, Shqipëri. Ky spital ofron shërbim shëndetësor terciar dhe është qendër spitalore kombëtare referimi për spitalet rajonale në vend.

Spitali fillimisht ka rekrutuar paciente në studimin WOMAN trial, dhe më vonë për nën-studimin WOMAN ETAPLaT duke arritur numrin e planifikuar brenda kohës së studimit WOMAN trial. Laboratori i spitalit ofron shërbimet e nevojshme të analizave që kanë lidhje me studimin, sic është analiza e gjakut komplet dhe testi i agregimit trombocitar me Multiplate, të cilat janë të përshkruara tek procedurat e operimit standart, si dhe laboratori ka aderuar proceset e kërkuara të kontrollit të cilësisë, dokumentet e të cilave janë të depozituara në dosjen kryesore të nën-studimit ETAPLaT.

9 Interventi i studimit.

Pacientet me diagnozë klinike HPP dhe që përmbushin kriteret e pranimit në studimin WOMAN trial, janë randomizuar në studim pasi kanë marrë mjekimin standart për trajtimin e HPP. Sa më shpejt ishte e mundur pas diagnozës së HPP primare, janë administruar medikamentet e studimit (TXA ose placebo), në të njëjten kohë që ishte duke u kryer edhe mjekimi standart i HPP. Secila

pako e trajtimit të studimit përmbante dy doza, dhe secila dozë përmban dy ampula me solucion TXA 500 mg ose dy ampula placebo me solucion natrium klorat 0.9%.

10 Rezultatet e Pritshme te Studimit

10.1 Rezultati paresor dhe sekondar i studimit ETAPLAT

Rezultati primar i pritshëm i nën-studimit WOMAN ETAPLaT është efekti i TXA në gjenerimin e trombinës dhe ndryshimi ETP (para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit) krahasuar me placebo. Gjenerimi i trombinës (ETP) është zgjedhur si rezultati primar sepse është një tregues i aktivitetit të koagulimit (Sponk et al, 2008) dhe faktorët që rrisin formimin e trombinës, mund të rrisin potencialisht riskun trombotik (Hemker et al, 2004).

Rezultatet sekondare të pritshme përfshijnë efektin e TXA dhe ndryshimin (para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit) në funksionin trombocitar (ADPtest and TRAPtest) dhe të faktorëve të koagulimit V, VIII, von Willebrand, Fibrinogjen, D-Dimer, krahasuar me placebo. Rezultate të tjera sekondare do të përfshijnë vlerësimin e ndërveprimit midis parametrave të mësipërm, të dhënave demografike të pacienteve dhe të dhënave të tjera klinike të periudhës kohore nga randomizimi deri në daljen nga spitali të pacientes ose gjatë lehonise deri në ditën e 42 pas lindjes.

10.2 Rezultatet e Pritshme te studimit WOMAN trial

Rezultati i pritshëm parësor i WOMAN trial është investigimi i grave me hemorragji postpartum që vdesin ose kryejnë hysterektomi. Në rezultatet sekondare përfshijnë ndërhyrjet kirurgjikale për të kontrolluar hemorragjinë, hemotransfuzionet, raportimi i cilësisë së jetës lidhur me shëndetin si dhe eventet tromboembolike (infarti miokardit, embolia pulmonare, tromboza e venave të thella). Studimi WOMAN trial (Shakur at al, 2010) nuk jep të dhëna për efektin e TXA mbi gjenerimin e trombinës, funksionin trombocitar dhe faktorëve të koagulimit V, VIII, vWF, fibrinogjen dhe D-dimer, të cilat i raporton studimi ETAPLaT.

11 Procedurat e Operimit Standart.

Procedurat e operimit standart (POS) janë disa: marrja e gjakut, procedimi i gjakut, ruajtja dhe analizimi i këtyre mostrave, transferimi i mostrave të plazmave të ngrira dhe analizimi i tyre në Mynih, Gjermani, si dhe procesi i transferimit të rezultateve në Qendrën e Koordinimit të Studimit në LSHTM, Londer, Angli. Këto POS-e janë zhvilluar dhe miratuar nga të tre institucionet pjesëmarrëse, LSHTM, Londer, Angli, SUOGJ “Koço Gliozheni“ në Tiranë, dhe Instituti Laboratorit në Spitalin Gjerman të Zemrës (GHC), në Mynih, Gjermani. Dokumentet origjinale të POS-eve dhe dokumenti i miratimit firmosur nga përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse, janë të disponueshme në Dosjen Kryesore të Studimit.

Dokumentet e POS janë: (POS 01) Marrja e procesimi i gjakut, analiza e gjakut komplet, dhe analiza e funksionit trombocitar (ADPtest dhe TRAPtest), (POS 02) transferimi i mostrave të plazmes së ngrire në Mynih, Gjermani, (POS 03) analizat e metejshme nga mostrat plasmatike të ngrira në GHC, Mynih dhe transferimi rezultateve në LSHTM, Angli. (POS 03 GHC 01) analizat e gjenerimit të trombinës TGA, (POS 03 GHC 02, 03, 04, 05), dhe analiza e faktorëve të koagulimit (FV; FVIII; vWF, Fibrinogjen, D-dimer).

12 Procedurat e kryera per studimin ETAPlaT.

12.1 Definicioni HPP dhe matja e sasise se gjakut te humbur

Në pacientet me hemorragji paslindjes diagnoza klinike është vendosur e bazuar në vlerësimin vizual të sasisë së gjakut të humbur (pershkruar edhe në kriteret e pranimi në studim). Në lindjen vaginale është përcaktuar si hemorragji e paslindjes në rastet kur sasia e humbjes së gjakut është më shumë ose e barabartë me 500 ml. Sasia e gjakut të humbur është matur në bacinelin e shtratit të lindjes, si dhe me peshimin e pelenave të mbushura me gjak. Hemorragjia postpartum në lindjen cezariane është përcaktuar si humbja e sasisë së gjakut më shumë ose e barabartë me 1000 ml. Matja e sasisë së gjakut të humbur është bërë duke vlerësuar volumin e gjakut të aspiruar ose peshimi i kompresave operatore me gjak.

12.2 Marrja e mostrave të gjakut dhe procedimi laboratorik

Menjëherë pasi pacientja me diagnozën e HPP të jetë randomizuar dhe para aplikimit të dozës së parë të ilacit të studimit, merret një kampion gjaku venoz i cili mbledhet në dy epruveta 3 ml dhe 5ml. E njëjta procedure për mbledhjen e gjakut në dy epruveta 3 ml dhe 5ml është kryer 30±15 minuta pas administrimit të dozës së parë të ilacit të studimit. Procedura e dytë e mbledhjes së gjakut është kryer gjithmonë para administrimit të dozës së dytë të ilacit të studimit, nëse do të aplikohet (Figura 2).

Gjaku i marrë në epruveten 3 ml me mure të dyfishta, me hirudinë (25µgr/mL) prodhuar nga Dynabyte, Mynih, Gjermani) është përdorur për analizën e agregometrisë trombocitare me elektroda të shumëfishta me pajisjen Multiplate. Analiza e funksionit trombocitar me Multiplate është kryer në SUOGJ “Koço Gliozheni” në Tiranë, me të cilën janë kryer: ADP test (Adenosine Diphosphate test) dhe TRAP test (Thrombin Receptor Activating Peptide test). Pajisja Multiplate, reagentët dhe mjetet e saj të konsumit janë siguruar nga një donacion (shih financimet, paragrafi 18).

Gjaku i marrë në epruveten 5 ml, me tri-sodium citrate 0.106 mol/l⁻¹ (S-Monovette, prodhuar nga Sarstedt, Gjermani) është përdorur për testet e koagulimit. Gjaku i mbledhur në epruveten 5 ml është centrifiguar menjëherë në 3000xg për 20 minuta, dhe kampioni i plazmës (së varfer në trombocite) ndahet në dy alikuote 1.5 ml dhe pasi janë etiketuar janë ruajtur në ngrirje (-20°C) në SUOGJ “Koço Gliozheni”.

Temperatura është monitoruar dhe rregjistruar, si dhe kampionet e ngrira janë transferuar çdo 2 muaj në GHC në Mynih, Gjermani, ku janë ruajtur në ngrirje të thellë (-80°C) deri në fund të studimit, për tu analizuar të gjitha në të njëjtën kohë.




Figura 2. Algoritmi i nen-studimit WOMAN-ETAPlaT. Kutite e zeza: procedurat standarte te studimit WOMAN trial. Kutite e kuqe: procedurat shtese te nen-studimit WOMAN-ETAPlaT.

Këto kampione të plazmës së ngrirë janë transportuar nga SUOGJ “Koco Gliozheni” në Tiranë, në kushtet e ngrirjes së thellë (-80°C) me akull të thatë (nga kompania World Courier) në Institutin e Laboratorit të GHC në Mynih, Gjermani, për kryerjen e analizave: TGA, fibrinogen, D-dimer, FV, FVIII dhe vWF. Temperatura e mostrave të plazmës së ngrirë është monitoruar dhe dokumentuar, nga momenti i marrjes në dorëzim nga kompania e transportit, gjatë transportit dhe deri në mbërritjen në Laboratorin në Mynih, Gjermani, ku janë ruajtur në kushtet e ngrirjes së thellë (-

80°C), deri në analizimin e të gjithë mostrave në përfundim të randomizimit të rasteve në nën-studimin ETAPlaT.

Si pjesë e protokolleve të obstetrikës të SUOGJ “Koço Gliozheni” në Tiranë, analiza e gjakut komplet i bëhet çdo pacientje të shtruar në klinikën e obstetrikes, para lindjes. Ne rastet me HPP të randomizuara në studim, një analizë tjetër e gjakut komplet kryhet brenda 12 orësh pas randomizimit, ose edhe më shpejt në vartësi të sasisë së humbjes së gjakut. Diferenca e hemoglobines apo hematokritit para dhe pas randomizimit, do të matet për të vlerësuar sasinë e humbjes së gjakut, përveç matjes me vleresimin vizual të sasisë së gjakut të humbur.

12.3 Analiza e Funkzionit Trombocitar.

Mostrat e gjakut të plotë të marrë në epruvetat 3ml me hirudinë, para dhe pas aplikimit të ilacit të studimit, janë analizuar 10 minuta deri 60 minuta pas marrjes së mostrës, në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni“ në Tiranë. Këto mostra gjaku janë analizuar për agregimin trombocitar me pajisjen e vlerësimit të funksionit trombocitar, Multiplate. Testet që u kryen me Multiplate janë: testi ADP (Adenosine Diphosphate test) dhe testi TRAP (Thrombin Receptor Activating Peptide test). Agregimi trombocitar i matur me Multiplate ose me agregometrinë me elektroda të shumfishta është shprehur me njesinë: AU*min.

Multiplate është një sistem monitorimi për agregimin trombocitar me elektroda multiple, që vlereson performancën e agregimit trombocitar në gjakun e plotë. Kjo pajisje e krijuar kohët e fundit, ofron testim “point-of-care” apo testim në kohë të shpejtë dhe afër vendndodhjes të pacientes, si dhe ka sensitivitet të mirë për medikamentet që indukojnë inhibimin trombocitar. Multiplate ka avantazhet që eksploron funksionin trombocitar në ambientin që ka edhe elemente të tjerë qelizorë sic janë eritrocitet, monocitet, leukocitet dhe qelizat e tjera të gjakut. Kjo aparaturë e standartizuar përdor vetëm sasi të vogla gjaku të plotë, të holluar (Ranucci et al, 2011), dhe jep të dhëna për riskun trombotik apo riskun për hemorragji të rëndë në pacientet e ekspozuar ndaj trajtimit me medikamente, si dhe gjatë dhe pas ndërhyrjeve kirurgjikale.

Multiplate është raportuar në mjaft publikime, që është një aparaturë e vlefshme në fusha klinike të ndryshme (Adamzik et al, 2012). Kjo aparaturë lejon në të njëjtën kohë vlerësimin funksionit trombocitar në gjakun e plotë me disa aktivizues, në rastin e studimit tonë me ADP test dhe TRAP test. Vlerësimi i funksionit trombocitar ne ADP test bëhet nga nxitja e aktivitetit trombocitar nëpërmjet receptoreve trombocitar ADP, ndërsa TRAP testi investigon reaktivitetin trombocitar nga aktivizimi i receptorëve trombocitar të trombinës.

12.4 Gjenerimi i Trombines dhe Faktoret e Koagulimit.

Hemostaza në shtatëzani është studiuar nga shumë autorë duke përshkruar te ndare faktorët e koagulimit, aktivitetin fibrinolitik, dhe funksionin trombocitar. Analiza e gjenerimit të trombinës (TGA) një test global i hemostazës, është përdorur për të vlerësuar kapacitetin e gjenerimit të trombinës. TGA vlereson rezultatin përfundimtar të një ndërveprimi dhe reaksioni enzimatik kompleks. Testi global i hemostazës për matjen e kapacitetit individual për të gjeneruar trombinë me përdorimin e gjakut të plotë apo të plazmes, është konsideruar si indikator më i mire i tendencës së trombozës apo të hemorragjisë, krahasuar me testet e tjera bazë të koagulimit (McLean et al, 2012).

Duke ditur që trombina si një enzime finale dhe që ka efekt madhor në procesin e koagulimit, TGA është një test i rëndësishëm për koagulibilitetin plazmatik (Baglin 2005). Për shkak të rolit të saj central, formimi i trombinës është konsideruar si një nga hapat më të rëndësishme të koagulimit. TGA njihet si një egzaminim mjaft i dobishem për stratifikimin e riskut hemorragjik në pacientet me formë të rëndë të hemofilisë, dhe më i saktë se sa testimi i vlerave të aktivitetit të faktorit VIII të koagulimit (Nagel et al 2011).

TGA mund të ofrojë informacion shtese për të stratifikuar më saktë shkallën e deficiencës së faktorit VIII të koagulimit dhe të parashikojë incidencën e hemorragjisë të këtyre pacienteve krahasuar testet e ativitetit të faktorëve të koagulimit. Disa nga këta paciente me trombocitopeni mund të rrisin tendencën hemorragjike, dhe kjo rritje e tendencës për hemorragji mund të investigohet më mirë nga TGA sesa nga matja e nivelit plazmatik i faktorit të VIII të koagulimit (Vila et al, 2012). Në pacientet me hemorragji të pashpjegueshme, egzaminimi me TGA mund të

zbulojë defektin kryesor të koagulimit, dhe ky test është mjaft sensitiv për të zbuluar këtë krahasuar me testet konvencionale të koagulimit (Ay et al 2011).

Testet laboratorike të gjenerimit të trombinës dhe faktorëve të koagulimit janë kryer nga mostrat plasmës së varfër në trombocite (ruajtur në ngrirje të thellë) të cilat janë analizuar në Institutin e Laboratorit Mjekësor, Spitalin Gjerman të Zemrës në Mynih, Gjermani. Aparati që ka kryer analizën e gjenerimit të trombinës është Calibrated Automated Thrombogram®, prodhuar nga Thrombinoscope BV (Stago Deutschland GmbH). Parametri kryesor i TGA është potenciali endogen i trombones (ETP), shprehur me nMol për minutë, si dhe parametrat e tjerë të TGA janë: “lag time (LT), peak height (PH) dhe time to peak (TtP)”.

Faktorët e koagulimit V, VIII, von Willebrand, Fibrinogjen (analizuar me metodën Claus) dhe D-Dimer janë analizuar me SIEMENS BCS XP Coagulation Analyzer, duke përdorur reagentet deficient plasma FV dhe FVIII, reagent fibrinogjeni Multifibren*U, reagent BC von Willebrand dhe reagenti D-Dimer INNOVANCE®. Të gjithë reagentet e fatoreve të koagulimit janë furnizuar nga Siemens Healthcare Diagnostic Products GmbH, Marburg, Gjermani.

13 Rezultatet e studimit

Rekrutimi i pacienteve në nën-studimin WOMAN ETAPlaT filloi me 4 Nentor 2013 dhe mbaroi me 13 Janar 2015, me përfundimin e plotë të ndjekjes së rasteve dhe mbledhjes së të dhënave në 4 Mars 2015. Gjatë kohës së studimit 187 paciente u randomizuan, nga të cilët 93 paciente morën TXA dhe 94 paciente morën placebo. Për shkak të hemorragjisë refraktare ndaj trajtimit, nga këto 17 paciente në grupin TXA dhe 31 paciente në grupin placebo morën dozën e dytë të trajtimit të studimit (Figura 3).


Nuk ishte e mundur mbledhje e kampioneve të gjakut para apo pas administrimit të medikamentit të studimit për shkak të emergjencës së HPP, në 6 paciente dhe këto paciente u përjashtuan nga analiza statistikore. Numri i lindjeve për këtë periudhë ishte 5017, nga të cilat 1597 (31.8 %) ishin lindje cezariane dhe 3420 lindje vaginale. Prevalenca e hemorragjise paslindjes ishte 3.7 %.

Rezultatet për efektin e TXA në vdekshmërinë amtare dhe hysterektominë si dhe te dhenat e tjera te studimit kryesor, janë raportuar nga studimi WOMAN trial (Shakur et al, 2017). Të dhënat klinike dhe demografike para randomizimit për të dy grupet TXA dhe placebo, të cilat janë paraqitur në Tabela 1, ishin pa ndryshime signifikante midis tyre.

Një paciente e randomizuar në studim ne grupin e TXA, ishte diagnostikuar dhe mjekuar më parë me sëmundjen von Willebrand. Shkaku kryesor i HPP në pacientet pjesëmarrëse në studimin ETAPlaT ishte atonia uterine, 71 (76.3%) paciente u randomizuan në grupin TXA dhe 59 (62.7%) ne grupin placebo.

Mënyra e lindjes në grupin TXA ishte vaginale ne 65 (69.8 %) dhe sectio cesarea për 28 (30.1%) paciente, ndërsa në grupin placebo ishte 65 (69.1%) dhe 29 (30.8%) paciente, respektivisht. Sasia mesatare (SD) e gjakut të humbur ishte me e ulet në grupin TXA 863.2 (270.6) mL krahasuar me grupin placebo 893.1 (219.9) mL, megjithese ishte ndryshim jo-signifikant.

Mesatarja (SD) e nivelit plazmatik te fibrinogjenit para aplikimit te trajtimit te studimit, ishte 0.364 (0.108) g/L në grupin TXA dhe 0.349 (0.120) g/L në placebo. Mesatarja (SD) e numrit te trombociteve ishte 229.3 (80.4) $\times 10^3/\text{mm}^3$ në grupin TXA dhe 233.7 (80.1) $\times 10^3/\text{mm}^3$ në grupin placebo. Niveli hemoglobinës (mesatarja, SD) ishte 10.8(1.7) g/dL në grupin TXA dhe 11.3(1.6) g/dL në grupin placebo (Wilcoxon-Mann-Whitney-Test, $p= 0.01$).



* Pacientet për të cilët nuk ka të dhëna për rezultatin parësor. (2 paciente kishin mungesë të rezultatit të TGA para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit, 3 paciente kishin mungesë të rezultatit të TGA para aplikimit të trajtimit të studimit, dhe 1 paciente kishte mungesë të rezultatit të TGA pas aplikimit të trajtimit të studimit)

Figura 3: Progresi i pacienteve randomizuar ne studimin WOMAN ETAPlaT, sipas CONSORT.

Ne grupin TXA, mesatarja (mediana) e differences së kohës midis dy marrjeve të gjakut (para dhe pas aplikimit të trajtimit të studimit) ishte 30.0 (32.9) minuta. Në grupin placebo, mesatarja (mediana) e diferencës së kohës midis dy marrjeve të gjakut (para dhe pas trajtimit të studimit) ishte 30.0 (31.7) minuta.

Në grupin TXA, minimumi (maksimumi) i diferencës së kohës midis dy marrjeve të gjakut (para dhe pas trajtimit të studimit) ishte 20.0 (45.0) minuta, ndërsa në grupin placebo, minimumi (maksimumi) i diferencës së kohës midis dy marrjeve të gjakut (para dhe pas trajtimit të studimit) ishte 15.0 (63.0) minuta. Nuk ka evidenca të ndryshmit signifikant, të differences së kohës midis dy marrjeve të gjakut, tek dy grupet e trajtimit TXA/placebo (testi Wilcoxon-Mann-Whitney, $p = 0.13$).

	Grupi TXA N=93	Grupi Placebo N=94
Mosha materne - vite, mesatare (SD)	27.8 (5.6)	27.0 (5.6)
Indeksi Mases Trupore - kg/m ² , mesatare (SD)	28.5 (3.1)	29.9 (4.8)
Mosha gestacionale lindje – javë, mesatare SD)	38.3 (2.8)	38.2 (3.4)
Pesha fetale ne lindje – gram, mesatare (SD)	3185 (695.2)	3222 (843.8)
Hemoglobina - g/dL ⁺ , mesatare (SD)	10.8 (1.8)	11.4 (1.6)
Fibrinogjen - g/L, mesatare (SD)	3.6 (1.1)	3.5 (1.2)
Trombocitet 10 ³ /mm ³ , mesatare (SD)	229.3 (80.4)	233.7 (80.1)
Sasia e gjakut te humbur –mL, mesatare (SD)	863.2 (270.7)	893.1 (219.9)
Lindjet vaginale- Stadi pare (ore) mesatare (SD) [N]	6.7 (4.3) [71]*	7.8 (4.1) [68]*
Stadi dyte (min)	40.5 (26.0) [67]*	48.5 (31.6) [66]*
Stadi trete (min)	10.9 (9.1) [66]*	13.5 (12.4) [65]*
Pariteti : N (%), Nullipara	57 (61.3 %)	60 (63.8 %)
Multipara	36 (38.7 %)	34 (36.2 %)
Tipi i Lindjes: N (%), Vaginale	65 (69.9%)	65 (69.2%)
Cezariane	28 (30.1%)	29 (30.8%)
Shkaku primar i HPP: N (%), Placenta previa	11 (11.8%)	14 (14.9%)
Trauma Kirurgjikale/laceracionet	10 (10.8%)	19 (20.2%)
Atonia uterine	71 (76.3%)	59 (62.8%)
tjeter	1 (1.1%)	1 (1.1%)
e panjohur	0 (0%)	1 (1.0%)
Preeclampsia: N (%), Po	11 (11.8 %)	7 (7.4 %)
Jo	82 (88.2 %)	87 (92.6 %)
Chorioamnionitis: N (%), Po	5 (5.4 %)	6 (6.4 %)
Jo	88 (94.6 %)	88 (93.6 %)
Distako Placentare: N (%), Po	9 (9.7 %)	5 (5.3 %)
Jo	84 (90.3 %)	89 (94.7 %)
Anemia: N(%), Po	34 (36.6 %)	23 (24.5 %)
Jo	59 (63.4 %)	71 (75.5 %)
HPP e meparshme: N (%)Po	3 (3.2 %)	6 (6.4 %)
Jo	90 (96.8 %)	88 (93.6 %)
Semundje Hematologjike N (%)Po	1 (1.1 %)	0 (0%)
Jo	92 (98.9 %)	94 (100 %)
Trajtim me antitrombotike N (%)Po	0 (0%)	2 (2.1 %)
Jo	93 (100 %)	92 (97.9 %)

* Pacientet me lindje vaginale; ⁺Vlera p me testin Wilcoxon-Mann-Whitney: 0.01

Tabela 1: Karakteristikat e pacienteve para randomizimit.

13.1 Rezultati primar

Tabela 2, Figura 4A dhe 4B paraqesin vlerat e rezultateve të detajuara, të raportuara me intervalin e konfidencës 95% si dhe vleren e p së differences së thjeshtë dhe të rregulluar për kohën midis marrjeve të gjakut. Ndryshimi i ETP, shprehur në nM*min, para dhe pas trajtimit të studimit ishte 43.2 (95%CI, -16.6 to 103.1) në grupin TXA, dhe 4.6 (95%CI, -51.4 to 60.6) në grupin placebo.

Diferenca e diferencave (DeD) ishte 36.63 (TXA minus Placebo) nuk ishte statistikisht signifikante (p.raw =0.350, 95%CI raw, -42.9 deri 120.0).




Figura 4A.Pamja grafike e grupeve TXA dhe Placebo: para dhe pas aplikimit te trajtimit te studimit.




Figura4B. Paraqitja grafike e kohes midis dy marrjeve te gjakut (para dhe pas aplikimit, grupi TXA – zeze; grupi placebo - e kuqe), dhe shperndarja e vlerave individuale te differences se ETP.

	Para trajtimit Mesatare (SD)	Pas trajtimit Mesatare (SD)	Diferenca Mesatareve Para-Pas trajtimit (95% CI)	DeD: Grupet TXA / Placebo DeDMesatareve (95%CI) Vlera-p
ETP (nM*min)				
TXA (N=87)	1537 (375.9)	1494 (369.1)	43.2 [-16.6; 103.1]	36.63 [-42.9; 120.0] p _{raw} = 0.350* 29.81 [-47.8; 107.4] p _{adj} = 0.453**
Placebo (N=94)	1491 (378.7)	1487 (390.5)	4.6 [-51.4; 60.6]	
ADPtest (AU*min)				
TXA (N=89)	1043.0 (343.6)	964.7 (312.4)	78.0 [15.4; 140.6]	13.2 (-65.8; 92.2) p _{raw} = 0.7* -0.9 (-72.7; 70.9) p _{adj} = 1.0**
Placebo (N=91)	961.6 (339.6)	896.8 (356.8)	64.8 (15.8; 113.7)	
TRAPtest (AU*min)				
TXA (N=89)	1199 (362.3)	1093 (300.3)	106.2 (38.5; 174.0)	20.9 (-65.3; 107.1) p _{raw} = 0.6* 1.5 (-72.8; 75.7) p _{adj} = 1.0**
Placebo (N=91)	1156 (347.9)	1070 (336.8)	85.3 (31.2; 139.4)	
Faktori V (%)				
TXA (N=88)	103.4 (27.7)	103.4 (25.7)	0.1 (-4.6; 4.8)	-4.2 (-10.0; 1.7) p _{raw} = 0.2* -4.9 (-10.4; 0.7) p _{adj} = 0.1**
Placebo (N=94)	100.2 (28.5)	95.9 (29.2)	4.3 (0.7; 7.8)	
Faktori VIII (%)				
TXA (N=88)	221.9 (102.4)	216.1 (87.4)	5.9 (-9.5; 21.2)	5.9 (-13.9; 25.6) p _{raw} = 0.6* -0.9 (-18.7; 17.6) p _{adj} = 1.0**
Placebo (N=94)	195.2 (87.0)	195.2 (87.4)	0.0 (-12.7; 12.7)	
Faktori vW (%)				
TXA (N=88)	219.4 (89.8)	222.2 (89.1)	-2.8 (-15.2; 9.7)	-0.1 (-16.9; 16.7) p _{raw} = 1.0* 1.3 (-15.0; 17.5) p _{adj} = 0.9**
Placebo (N=94)	212.6 (92.6)	215.3 (92.0)	-2.7 (-14.1; 8.8)	
Fibrinogjen (g/L)				
TXA (N=87)	3.64 (1.09)	3.59 (1.07)	0.05 (-0.1; 0.2)	-0.08 (-0.29; 0.12) p _{raw} = 0.4* -0.09 (-0.28; 0.1) p _{adj} = 0.4**
Placebo (N=93)	3.49 (1.2)	3.36 (1.1)	0.13 (-0.01; 0.27)	
D-Dimer (mg/L)				
TXA (N=88)	7.4 (9.3)	7.8 (10.2)	-0.4 (-1.1; 0.3)	0.9 (-1.3; 3.0) p _{raw} = 0.4* 1.5 (-0.2; 3.1) p _{adj} = 0.1**
Placebo (N=94)	9.6 (24.6)	10.8 (17.7)	-1.3 (-3.4; 0.8)	

Popullatat: Pacientet ku jane analizuar diferencat (N); DeD: Diferenca e Diferencave;

Analiza: * (raw) rezultatet e paperpunuara (DeD e thjeshte - 95% CI);

** (adj) pershtatur per rezultatet para randomizimit dhe kohën midis marrjes mostrave te gjakut.

Tabela 2: Efekti i TXA ne rezultatet primare dhe sekondare te studimit.

13.2 Rezultatet sekondare

Tabela 2 dhe figurat 5A, 5B, 5C, 5D, 5E, dhe 5F, paraqesin rezultatet sekondare eksploratore. Ndryshimi në aktivitetin trombocitar (shprehur në AU*min) në ADPtest ishte më i madh në grupin TXA ndryshimi mesatares DeD =78.0, (95%CI, 15.4 deri 140.6) krahasuar me grupin placebo ku ndryshimi mesatares ishte DeD=64.8, (95%CI, 15.8 deri 113.7), por diferenca e diferencave ishte jo statistikisht signifikante DeD=13.2, (95%CI, -65.8 deri 92.2). Diferenca e mesatares së TRAPtest për grupin TXA ishte DeD =106.2 (95%CI, 38.5 deri 174.0) krahasuar me grupin placebo DeD= 85.3 (95%CI, 31.2 deri 139.4).




Figura 5A. Paraqitja grafike e rezultateve (para dhe pas trajtimit) ne dy grupet, per ADPtest.




Figura 5B. Paraqitja grafike e rezultateve (para dhe pas trajtimit) ne dy grupet, per TRAPtest.




Figura 5C. Paraqitja grafike e krahasimit te diferencave te FV, para e pas trajtimit, per dygrupet




Figura 5D. Paraqitja grafike krahasimit te diferencave te vWF para dhe pas trajtimit, ne dy grupet.




Figure 5E. Paraqitja grafike e krahasimit te diferencave te FVIII (para e pas trajtimit), ne dy grupet.

Nuk rezultoi diferencë (DeD) signifikante midis grupeve të trajtimit për aktivitetin e faktoreve të koagulimit (shprehur në % të aktivitetit të normës). Rezultatet janë si më poshtë: faktori koagulimit V DeD = -4.2, (95%CI, -10.0 deri 1.7); faktori koagulimit VIII DeD= 5.9, (95%CI, -13.9 deri 25.6); dhe faktori koagulimit von Willebrand DeD= -0.1, (95%CI, -16.9 deri 16.7).




Figure 5F. Paraqitja grafike e rezultateve per Fibrinogjenin (para dhe pas trajtimit) ne dy grupet.




Figure 5G. Paraqitja grafike e rezultateve per D-dimerin (para dhe pas trajtimit) ne dy grupet.

Nuk rezultuan ndryshime signifikante të diferencës për fibrinogjenin (shprehur ne g/L) DeD -0.08 (95%CI, -0.29 deri 0.12); dhe D-Dimeri (shprehur me mg/L), DeD = 0.9 (95%CI, -1.3 deri 3.0), paraqitur në mënyrë grafike në Figurën 5F dhe 5G.

Efekti i TXA në vlerat e D-dimerit në pacientet me HPP, u vleresua në një meta-analize të dy nën-studimeve ETAC dhe ETAPlaT (Shakur-Still et al, 2018), që janë pjesë e studimit kryesor WOMAN trial, paraqitur në Figuren 6. Rezultati i kesaj meta-analize ishte një reduktim signifikant i d-dimerit ($p=0.008$) në pacientet e grupit të TXA krahasuar me grupin placebo.




Figura 6. Grafiku i efektit të TXA në vlerat e D-dimer në pacientet me HPP.

14 Diskutimi

Studimi ETAPlaT vlerëson impaktin e TXA në gjenerimin e trombinës dhe funksionit trombocitar, në pacientet me hemorragji postpartum. Evidenca e këtij studimi tregon që acidi tranexamik nuk ka efekte të mëdha në gjenerimin e trombinës apo në funksionin trombocitar. Megjithatë, ne nuk mund ti përjashtojmë mundësitë e efekteve më modeste. Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë një reduktim të vogël të gjenerimit të trombinës dhe të aktivitetit trombocitar në pacientet e grupit TXA, krahasuar me grupin placebo. Kjo evidencë tregon që acidi traneksamik nuk e rrit riskun trombotik, në gratë me hemorragji postpartum.

14.1 Efekti i TXA në gjenerimin e trombinës, në pacientet me HPP.

Trombina është një enzimë që ka një efekt mjaft të rëndësishëm në koagulim, dhe gjenerimi i trombinës është konsideruar një tregues i funksionit të sistemit hemostatik (Spronk et al, 2004). Rritja e gjenerimit të trombinës shoqërohet me rritje të riskut trombotik (Hemker et al, 2004). Plasmina është raportuar në një studim in-vitro që e rrit gjenerimin e trombinës në gjakun e vullnetarëve të shëndetshëm (Ogiwara et al, 2010).

Megjithëse trajtimi me koncentratin e kompleksit të protrombines së aktivizuar (APCC) tek pacientet hemofilike, e rrit gjenerimin e trombinës, dhënja në të njëjtën kohë e terapise se kombinuar të APCC me TXA, është raportuar që e pakëson gjenerimin e trombinës krahasuar me pacientet me terapi vetem me APCC (Holmstrom et al., 2012). Reduktimi i gjenerimit të trombinës në administrimin e kombinuar të APCC me TXA, është gjetur edhe nga autorë të tjerë (Tran et al, 2014; Valentino et al, 2015). Ky reduktim i gjenerimit të trombines në rastet e administrimit të kombinuar të APCC me TXA krahasuar me pacientet vetem me APCC, ka mundësi të jetë për shkak të inhibimit të pasminës nga acidi traneksamik.

Rritje e gjenerimit të trombinës nga plasmina është referuar gjatë trajtimit me aktivizuesit e plasminogenit indor, të cilët rrisin prodhimin e plasminës (Gulba et al, 1991). Krahasuar me gjendjen para shtatzanise, gjatë shtatzanisë vërehet një rritje e gjenerimit të trombines (Mc Lean, 2012), e cila krijon për gruan shtatzane një gjendje relativisht pro-trombotike.

Pas administrimit të antikoagulantëve, sic janë heparinat me peshe molekulare të ulët, në periudhën postpartum shpejt pas lindjes cezariene, ETP është reduktuar me rreth 30% (Ismail et al, 2012). Reduktimi i ETP është raportuar gjithashtu gjatë trajtimit me antikoagulantë në shtatzani, në një studim in-vitro (Rossetto et al, 2012). Në studimin tonë ishte një ulje e vogël (3%) e ETP me administrimin e TXA (DeD = 36.63, 95% CI, -120 deri 42.8) e cila nuk ishte një reduktim i rëndësishëm krahasuar me grupin placebo. Ky rezultat paraqet evidencë që TXA nuk ka efekt pro-trombotik, në pacientet me HPP.

14.2 Efekti i TXA në funksionin trombocitar, në pacientet me HPP.

Plasmina ka efekte të shumfishta pro-koagulante në aktivitetin trombocitar. Plasmina indukon agregimin trombocitar në rrugë të ndryshme, stimulon çlirimin e acidit arakidonik (Majumdar et al, 2004), si dhe nxit degranulimin dhe aktivizimin e komplementit (Godier et al, 2012). Studimet in-vitro kanë treguar që aktivizuesit e plasminogenit indor (tPA) në përqëndrime terapeutike, mund të shkaktojnë disfunkcion trombocitar për shkak të prodhimit të plasminës (Stricker et al, 1986). Formim defektiv i trombines ka rezultuar nga terapia me aktivizuesit e plasminogenit indor, si

rezultat i rritjes së agregimit trombocitar nga plasmina (Ishii-Watabe et al, 2000). Gjithashtu, së fundmi një studim me terapinë me tPA raporton se është shoqëruar me aksidente trombotike cerebrale, për shkak të aktivizimit të komplementit nga plasmina (Zhao et al, 2017).

Ekspozimi i trombociteve në përqëndrime të vogla të plasminës indukon aktivizimin trombocitar, gjë që mund të kontribuojë në rritjen e komplikacioneve trombotike (Ervin et al, 2001). Aktivizimi i trombociteve mund të kontribuojë në formimin e trombit (Hvas A, 2016). Vlerësimi i aktivitetit trombocitar në MEA me ADPtest dhe TRAPtest jep informacion nëse ka rritje të riskut trombotik. Rangu i vlerave të ADPtest i raportuar tek vullnetaret e shëndetshëm është 483 deri 1173 AU*min, ndërsa për TRAPtest rangi i vlerave i raportuar është 897 deri 1469 AU*min (Rubak et al, 2012).

Observimet në studimin tonë janë të krahasueshme në të dy grupet e trajtimit, dhe përputhen me rezultatet e Rubak (2012). Këto rezultate tregojnë një ulje modeste megjithëse jo signifikante, të aktivitetit trombocitar në ADPtest dhe TRAPtest gjatë trajtimit me TXA krahasuar me grupin placebo. Kjo sugjeron efektin e TXA në inhibimin e plasminës dhe si rezultat reduktimin e disfunksionit trombocitar të shkaktuar nga plasmina. Edhe një herë keto rezultate të testeve të funksionit trombocitar, evidentojnë që TXA nuk ka efekt pro-trombotik në pacientet me HPP.

14.3 Efekti i TXA në fibrinolizë dhe koagulim, në pacientet me HPP.

Në tremujorin e fundit të shtatzanisë, nivelet plasmatike të plasminogenit dhe fibrinogjenit rriten rreth 50%, ndërsa nivelet e inhibitorëve 1 dhe 2 të aktivizuesit të plasminogenit rriten tre-fish deri 25-fish, respektivisht (Cesarman-Maus et al, 2005), tregojnë për rritje të gjendjes pro-koagulante gjatë shtatzanisë. Menjëherë pas lindjes, ka një aktivizim të fibrinolizes, e cila mund të inhibohet nga TXA (Ducloy-Bouthors et al, 2016). Nga ana tjetër ky inhibim i fibrinolizës nga TXA, ka potencialin të rrisë riskun trombotik (Blanié et al, 2013).

Duke reduktuar fibrinolizën, TXA mund të ndihmojë të ruajë nivelin e fibrinogjenit dhe të reduktojë prodhimin e produkteve të degradimit të fibrinogjenit, D-dimerit. Matja e nivelit të D-dimerit, i cili është një indikator indirekt i fibrinolizës, dhe ulja e prodhimit të D-dimerit në

pacientet nën trajtim me TXA, tregon që shkatërrimi i fibrinës ka ndaluar (Stein et al, 2017). Në studimin tonë, ulja e nivelit plazmatik të fibrinogjenit (DeD= -0.08,95%CI; -0.29 deri 0.12) ishte më e vogël në grupin e TXA krahasuar me placebo, por persëri diferenca nuk ishte signifikante.

Gjithashtu, trajtimi me TXA u shoqërua me reduktim të nivelit plazmatik të D-dimerit (DeD-0.86,95%CI, -3.05 deri 1.33) në grupin e TXA krahasuar me grupin placebo. Efekti i TXA në reduktimin e nivelit plazmatik të D-dimerit i vërejtur në këtë studim është i njëjtë me atë të observuar në nën-studimin WOMAN-ETAC (Shakur-Still et al, 2018).

Rezultatet e të dy studimeve iu nënshtruan meta-analizës (Figura 6), dhe rezultati ishte një reduktim signifikant prej 26% të nivelit të D-dimerit (pooled D-dimer ratio 0.74, 95% CI 0.60 - 0.93, p=0.008) në grupin e pacienteve të TXA krahasuar me grupin placebo. Rezultate të ngjashme janë raportuar më parë në një studim në France (Kruithof et al, 1987) ku tregohet që rritja e hershme e vlerave të D-dimerit në gratë me HPP, mund të inhibohet nga administrimi i TXA.

Administrimi i TXA në pacientet me hemorragji postpartum redukton në mënyre signifikante vdekjen për shkak të hemorragjisë, raportohet nga studimi Woman trial i cili përfshiu 20060 paciente (WOMAN trial co., 2017). Ky studim raporton një reduktim signifikant të laparotomisë për të kontrolluar hemorragjinë në pacientet me HPP në grupin e TXA krahasuar me grupin placebo. Incidenca e ngjarjeve tromboembolike (embolia pulmonare, tromboza e venave të thella, infarkti miokardit, insulti cerebral), nuk ndryshonin në mënyrë signifikante në grupin e TXA krahasuar me placebo.

Nuk u gjetën evidenca për efekte anësore të TXA në gratë me hemorragji paslindjes, dhe po ashtu nuk u raportuan ngjarje tromboembolike në fëmijët e porsalindur të ushqyer me gjë. Evidenca e studimit WOMAN trial sugjeron administrimin e hershëm të TXA, brenda tre orëve nga diagnoza e hemorragjisë postpartum, i cili redukton në mënyrë signifikante vdekjen për shkak të hemorragjisë, dhe kërkesën për laparotomi për të kontrolluar hemorragjinë. (WOMAN trial co, 2017).

15 Kufizimet e studimit

Ky studim ishte dizenuar për të provuar një diferencë në lidhje me trajtimin e TXA krahasuar me placebo, dhe nuk ishte planifikuar të gjejë një ekuivalence terapeutike. Nuk ka kufij të paracaktuar të ekuivalencës terapeutike, e cila mund të lejojë një krahasim midis rezultatit të diferencës (DeD) dhe intervalit të konfidences. Studimi përdor një seri me rezultate sekondare dhe teste, në një terren eksplorativ.

Në studimin ETAPlaT, megjithëse ne nuk matëm direkt plazminën por vleresuar gjenerimin e trombinës dhe funksioni trombocitar, si një efekt indirekt i TXA në inhibimin e plasminës. Disa përjashtime post randomizimit janë bërë nga analiza statistikore, për shkak të situatave emergjente të HPP ishte e vështirë të merreshin mostrat e gjakut, para apo pas aplikimit të trajtimit të studimit.

16 Konkluzion

Në këtë studim u investigua mundësia e efekteve pro-trombotike të acidit tranexamik në gjenerimin e trombinës, funksionin trombocitar dhe faktorët e koagulimit V, VIII, VWF, fibrinogjen dhe D-dimer. Rezultatet tregojnë për një reduktim të gjenerimit të trombinës dhe të aktivitetit trombocitar në grupin e pacienteve nën trajtimin me acidin traneksamik krahasuar me grupin placebo, megjithëse këto ndryshime nuk ishin të rëndësishme. Nuk u gjetën ndryshime midis grupeve në aktivitetin e faktorëve të koagulimit V, VIII, vWF.

Ndryshime të vogla rezultuan por jo të rëndësishme në vlerësimin e nivelit plasmatik të fibrinogjenit, ku u vu re një reduktim më i vogël i nivelit të fibrinogjenit në grupin TXA krahasuar me grupin placebo. Një reduktim i rëndësishëm i D-dimerit rezultoi në grupin e acidit traneksamik krahasuar me placebo, në meta-analizen e kryer të dy nën-studimeve të WOMAN trial, studimi ETAPlaT dhe studimi ETAC. Këto rezultate tregojnë për inhibimin e fibrinolizës nga TXA në pacientet me HPP.

Megjithëse gjatë shtatëzansit dhe në periudhën e hershme postpartum ka një rritje të aktivitetit të koagulimit, dhe inhibimi i fibrinolizës me TXA ka potencialin e rritjes së riskut trombotik, ne nuk gjetëm rritje të gjenerimit të trombinës dhe po ashtu nuk kishte rritje të aktivitetit trombocitar. Si

konkluzion, ky studim paraqet evidencë që acidi traneksamik nuk ka efekt pro-trombotik në pacientet me hemorragji të paslindjes.

17 Rekomandimet

Rezultatet e studimit kanë një rëndësi të madhe në praktikën klinike për përdorimin e acidit traneksamik në hemorragjinë e paslindjes dhe në kirurgjinë obstetrikale. Evidenca e këtij studimi që TXA nuk e rrit riskun trombotik në pacientet me hemorragji postpartum, e bën më të sigurtë aplikimin e tij në keto raste, duke kontribuar në reduktimin e komplikacioneve të hemorragjisë postpartum dhe si rrjedhim, reduktim të mortalitetit dhe morbiditetit matern.

Bazuar në rezultatet studimit ETAPlaT dhe të studimit WOMAN trial, rekomandohet trajtimi me acidin traneksamik në hemorragjinë e paslindjes, si më poshtë:

- Administrimi i TXA duhet të bëhet sa më shpejt nga fillimi i hemorragjisë dhe në të njejtën kohë me trajtimin standart, në pacientet e diagnostikuara me hemorragji postpartum.
- TXA duhet të aplikohet në të gjitha rastet e HPP pas lindjes cezariane apo vaginale, pavarësisht shkakut të hemorragjisë, nëse ajo është shkaktuar nga trauma e traktit genital apo shkaqet e tjera.
- TXA duhet të administrohet në rrugë intravenoze me një dozë fikse 1 gram në 10 mL, 1 mL për minutë, dhe nëse hemorragjia vazhdon edhe pas 30 minutash dhe brenda 24 orëve nga doza e parë, aplikohet një doze të dyte 1 gram.

18 Financimet

Studimi WOMAN është financuar nga Departamenti i Shëndetit në Angli (numri grantit HICF-T2-0510-007), Wellcome Trust në Angli (numri grantit WT094947), Fondacioni Bill & Melinda Gates (numri grantit OPP1095618), dhe LSHTM në Londër, Angli.

Nen-studimi ETAPlaT është mbështetur me një grant edukativ nga programi Erasmus Mundus, ERAWEB [D2.12.048] dhe Fondacioni Rudolf Marx në Mynih, Gjermani, i cili mundësoi pajisjen Multiplate dhe reagentet, transportin e mostrave të plazmave të ngrira në Laboratorin e Mynihut, dhe analizimin e tyre në këtë laborator.

Sponsori i studimit, LSHTM dhe financuesit, nuk patën asnjë rol në metodën e studimit ETAPlaT, mbledhjen e të dhënave, analizën e tyre, përgatitjen dhe publikimin e të dhënave të studimit.

19 Referencat

1. Oyelese Y, Ananth C,(2010) Postpartum Hemorrhage: Epidemiology, Risk Factors, and Causes. *Clinical Obstetrics and Gynecology*,Vol. 53, No. 1, 147–156
2. Ferrer P, Roberts I, Sydenham E, Blackhall K and Shakur H (2009) Anti-fibrinolytic agents in post partum haemorrhage: a systematic review. *BMC Pregnancy and Childbirth*, 9:29
3. AbouZahr C: Antepartum and Postpartum Haemorrhage, in *Health Dimensions of Sex and Reproduction* 1st edition. Edited by: Murray, Lopez J, Boston A. Harvard School of Public Health on behalf of the World Health Organisation and the World Bank; 1998:165-187.

4. Lalonde A, et al.: Postpartum hemorrhage today: ICM/FIGO initiative 2004-2006. *Int J Gynaecol Obstet* 2006, 94(3):243-53.
5. Ekeroma AJ, Ansari A, Stirrat GM: Blood transfusion in obstetrics and gynaecology. *Br J Obstet Gynaecol* 1997, 104(3):278-84.
6. OBSH (2001): Global Database on Blood Safety WHO. Geneva; 2001:1-32.
7. Taylor C, et al.: Serious Hazards of Transfusion Annual Report 2007 SHoTSComitee. London (UK); 2008;
8. AbouZahr C: Global burden of maternal death and disability. *Br Med Bull* 2003, 67:1-11.
9. World Health Organization: The prevalence of anaemia in women: a tabulation of available information. WHO/MCH/MSM/92.2 1992
[http://whqlibdoc.who.int/hq/1992/WHO_MCH_MSM_92.2.pdf].
